



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
STRUKTURA ADMINISTRATIVE
PAS MBARIMIT TË MANDATIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT**

Nr. 52 / 4 regj.

Tiranë, më 22.7.2026

**NJOFTIM
SHPALLJE PUBLIKE PËR VENDIMIN (JR) NR. 1, DATË 13.01.2026**

Subjekti i rivlerësimit: TONIN STERKAJ

Në zbatim të neneve 133/a dhe 133/b të K. Pr. Civile, bëhet "Njoftim me shpallje publike" i vendimit (JR) nr. 1, datë 13.01.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj.

Ky njoftim së bashku me vendimin do të qëndrojë i afishuar për jo më pak se 20 ditë, në këndin e Njoftimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe do të botohet në rubrikën "Shpallje" në linkun: <http://kpa.al/shpallje>.

Shpallja është afishuar sot më datë 22 / 07 / 2026
(Emër, Mbiemër)
(Nënshkrimi)

(*Kevin Kovajev*)






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 52 regjistër (JR)

Datë 16.12.2024

Nr. 1 i vendimit

Datë 13.01.2026

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 13.01.2026, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 52/2024 (JR), datë 16.12.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Tonin Sterkaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 795, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet A-G të Aneksit të Kushtetutës; nenet 5/2 dhe 63 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; jurisprudenca e GjEDNj-së dhe Gjykatës Kushtetuese, Opinionet e Komisionit të Venecias për Shqipërinë etj.



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj, të paraqitura në ankimin e depozituar në Kolegj, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 795, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Tonin Sterkaj (në vijim "subjekti i rivlerësimit"), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, lu nënshtrova procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar² duke konstatuar se:
(i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
(ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë;*
(iii) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
(iv) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin e hartuar për subjektin e rivlerësimit Tonin Sterkaj, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim "KLGj") ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë me nr. {***} prot., datë 04.04.2018.



sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së, duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ për subjektin e rivlerësimit Tonin Sterkaj.

6. Bazuar në nenin 7, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Tonin Sterkaj, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 795, datë 04.09.2024, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.*
8. Ky vendim është marrë mbështetur në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes si më poshtë.

8.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

8.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni nuk ka arritur në një përfundim konkret, por informacionet e përfituara gjatë verifikimit të këtij kriteri i ka vlerësuar në raport me shqyrtimin e disa çështjeve gjyqësore penale të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.

8.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *[...] Qëndrojnë gjetjet e evidentuara në raportin për analizën e aftësive profesionale, që lidhen me: (i) tejkalimin e afatit standard të gjykimit në disa dosje; (ii) mosrespektimin e standardit të transparencës dhe solemnitetit në gjykim, në zhvillimin e seancave pa regjistrim audio; (iii) vonesën në zhvillimin e seancave gjyqësore pa dokumentuar shkakun e vonesës. [...] trupi gjykues, në bazë të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi, si dhe mbi vendimmarrjen e bërë nga subjekti për çështjen gjyqësore penale me të pandehur shtetasit A. N. dhe E. T. – të administruar bazuar në informacionet/sinjalizimet e përfituara nga institucionet e verifikimit – nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por gjithsesi konkludon që këto gjetje t'i vlerësojë në tërësi me gjetjet e tjera në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në raport me pasojat që kanë sjellë te publiku në drejtim të cenimit të besimit të sistemi i drejtësisë.*

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. (***) prot., datë 03.01.2022.

8.4. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni ka konkluduar se: [...] Bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjyqësor arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi: (i) evidentohen mospërputhje/deklarime kontradiktore në lidhje me dy hua të marra në vitin 2009 dhe destinacionin e tyre; (ii) rezulton se ka përfituar tokë bujqësore në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991, "Për tokën", si dhe disponon një shtëpi banimi në fshat – pa provuar ligjërisht mënyrën e fitimit të pronësisë mbi të; (iii) evidentohen raste të përsëritura për vonesa në zbardhjen e vendimeve dhe zgjatjes së gjyqimit tej afateve standarde, të cilat kanë cenuar garancitë për një proces të rregullt ligjor; (iv) për një rast është çmuar se ka kryer vendimmarrje jo në vlerësim objektiv të rrethanave të ngjarjes, fakteve dhe provave të administruara në fashikullin gjyqësor.

III. Shkaqet e ankimit

9. Kundër vendimit të Komisionit nr. 795, datë 04.09.2024, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke ngritur pretendime me natyrë procedurale dhe materiale. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të krijimit të pasurive, duke pretenduar se konkluzionet e arritura nga Komisioni, bazuar edhe në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit. Bazuar në nenet 63, pika 1, 65 dhe 66, pika 1, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 51, pika 1, shkronjat "a", "b" e "c" dhe 54, shkronja "d" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjyqimit, të vendosë: (i) Prishjen e vendimit nr. 795, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjykimin e çështjes në themel nga KPA-ja dhe, në përfundim të gjyqimit të kësaj çështjeje në themel, konfirmimin e subjektit të rivlerësimit në detyrë. Ose: (ii) Ndryshimin e vendimit nr. 795, datë 04.09.2024, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj.
10. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1. Komisioni, në shqyrtimin e çështjes, ka kryer shkelje procedurale dhe të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat konsistojnë në: (i) vendimi është rezultat i vlerësimit të gabuar të fakteve të rezultuara e të vërtetuara gjatë procesit administrativ dhe është i pambështetur në prova dhe në ligj; (ii) vendimi është i paarsyetuar, nuk plotëson standardet kushtetuese të përcaktuara në vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese, është alogjik, kontradiktor, si dhe i bazuar në interpretime joobjektive, paragjyqëse dhe tendencioze, në interpretim të gabuar të frymës dhe qëllimeve të procesit të rivlerësimit, si dhe standardeve ekonomike, fiskale kontabël e tregtare; (iii) mosrespektimi nga Komisioni i garancive të procesit të rregullt ligjor, të konfirmuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016, ka sjellë një përfundim të gabuar mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kriterit profesional, përmbyllur me konkluzionin tërësor se është cenuar besimi i publikut te drejtësia; (iv) aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra nga Komisioni, është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë, sipas subjektit, kërkon plotësimin në

mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

11. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmblëdhur si më poshtë.

11.1. Në lidhje me pasurinë tokë-truall me sipërfaqe 240 m², blerë më datë 20.02.2001, në vlerën 500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit në ankim ka ngritur të njëjtat pretendime të paraqitura edhe në prapësimet e dërguara pranë Komisionit pas njoftimit të rezultateve të hetimit, duke pretenduar se pamundësia financiare e konstatuar nga Komisioni për blerjen e truallit në vitin 2001, është rezultat i rritjes artificiale të vlerës së shpenzimeve, përlogaritjes së pasaktë të shpenzimeve të jetesës, si dhe mosnjohjes si të ligjshme të të ardhurave nga punësimi, të ardhurave nga shitja e bagëtive të përfituara nga shpërbërja e kooperativës, gjatë qëndrimit në fshat, deri në tetor 1995, si dhe të të ardhurave nga bujqësia (prodhimet dhe shitjes së 6.783 kg bimë medicinale / timus 250-300 lekë/kg) për periudhën 1991-1995, në shumën 1.701.760 lekë.

11.2. Në lidhje me pasurinë shtëpi banimi me sipërfaqe prej 123,3 m², e ndodhur në qytetin e Shkodrës, subjekti ka ngritur pretendime në drejtim të: (i) kohës së përfundimit të ndërtimit, duke parashtruar se punimet e ndërtimit kanë vijuar edhe pas vitit 2003; (ii) kostos së ndërtimit, lidhur me të cilën ka pretenduar të merret parasysh fakti se ndërtimi është realizuar me ndihmën e familjarëve; (iv) kostos së garazhit, e cila nuk mund të jetë e njëjtë me atë të sipërfaqeve të banimit.

11.3. Në lidhje me pasurinë automjet i markës "Audi A 6" në vlerën 12.700 euro, me targë (***), subjekti ka pretenduar konsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga huatë e marra nga z. GJ. M. (kontratë noteriale huaje nr. {***}, rep., {***} kol., datë 01.04.2009) dhe z. A. N. S. (kontratë noteriale huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2008).

11.4. Në lidhje me pasurinë tokë bujqësore me sipërfaqe 6.300 m², fituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, datë 07.01.2011, si dhe pasurinë e llojit shtëpi banimi njëkatëshe, me sipërfaqe 90 m², të ndodhura në fshatin D., Malësia e Madhe, ndërtuar në vitin 1977 nga xhaxhai i tij, i ndjeri V. GJ. S., subjekti ka pretenduar se të drejtat reale të tij mbi këto pasuri, burojnë nga fakti se ai kishte qenë fëmijë "i fulur" të xhaxhai e, për rrjedhojë, ka trashëguar të gjitha pasuritë e tij. Po ashtu, subjekti ka potencuar se nuk ka trashëguar pasuri nga prindërit e tij biologjikë.

11.4.1. Në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni, për shtesë kati në banesën e ndodhur në fshatin D., si dhe për ndërtimin e një godine të re, ngjitur me banesën ekzistuese, subjekti ka shpjeguar se bëhet fjalë për riparim çatie të kësaj banese në vitin 2023, nga djali i tij K. S., me të ardhurat nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes në Itali – "{***}". Ndërsa, godina që gjendet pranë kësaj banese, ka ekzistuar dhe është përdorur fillimisht si kasolle për bagëti e, më pas, si magazinë për ruajtjen e bimëve medicinale.

11.5. Lidhur me pasurinë e llojit automjet i markës "Reno Modus", blerë në datën 11.07.2012, me vlerë 441.600 lekë, subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të kishte përfshirë në analizë të ardhurat e mbartura nga vitet paraardhëse – sipas aktit të ekspertimit kontabël të paraqitur nga subjekti, të njihen si të ligjshme të ardhurat e realizuara nga shitja e bimës sherbelë gjatë

viteve 2012-2015, si dhe të përjashtohen shpenzimet e jetesës së fëmijëve në Itali, për periudhën 01.01.2012 – 30.07.2012, pasi ato janë mbuluar nga familjet pritëse.

11.6. Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003-2016, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar rezultatin e analizës financiare për periudhën e vlerësimit, si pasojë e përlogaritjes në mënyrë të gabuar të disa prej zërave të kësaj analize.

12. *Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

12.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar gjetjet në raportin e KLGj-së, të konstatuara si të drejta edhe nga Komisioni, si dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni sa i takon shqyrtimit të denoncimeve duke parashtruar se: (i) *tejkalimi i afatit standard të gjykimit në disa dosje*, ka ardhur si pasojë e ngarkesës së tij në punë; (ii) *mosregjistrimi i seancave me audio*, kishte ndodhur pasi vetëm dy salla në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër mundësonin regjistrim audio; (iii) *vonesat në zhvillimin e seancave gjyqësore pa dokumentuar shkakun e vonesës*, kishin ardhur për shkaqe objektive të pavarura prej tij, si: zgjatja e seancave të mëparshme, vonesave të palëve apo prokurorit etj.; (iv) po ashtu, subjekti ka parashtruar se afatet e gjykimit nuk janë *prekluzive*, por orientuese për gjykatën për të vlerësuar në mënyrë të arsyeshme kohëzgjatjen e një procesi, dhe se Komisioni në disa raste ka dalë jashtë funksionit të tij procedural, duke marrë rolin e Gjykatës së Lartë, si dhe nuk ka mbajtur në konsideratë se vendimi i dhënë prej subjektit, është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta dhe në asnjë rast nuk është cenuar e drejta e palëve për një proces të rregullt ligjor.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegi, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përjashtim bëjnë rastet kur trupi gjyqësor gjen se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 795, datë 04.09.2024, të Komisionit, fillimisht u mor në shqyrtim nga trupi gjyqësor i Kolegjit në dhomë këshillimi.
16. Në përfundim, trupi gjyqësor, pasi kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë procesit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjyqësor çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit, nuk është i nevojshëm dhe se, lidhur me këtë çështje, mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

17. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka respektuar parimet e drejtësisë dhe paanësisë, të barazisë para ligjit, kontradiktoritetit, proporcionalitetit dhe objektivitetit, trupi gjyqësor vëren se në vendimin objekt ankimi, Komisioni ka argumentuar veprimet e kryera, ka vlerësuar provat dhe shpjegimet e subjektit, si dhe i ka analizuar ato në raport me kërkesat ligjore, duke pasqyruar konkluzionet për secilën çështje, për të cilat i ka kaluar subjektit barrën e provës. Gjatë hetimit në Komision, subjekti nuk ka ngritur asnjë pretendim për cenim të barazisë së armëve apo kontradiktoritetit në procesin e hetimit në Komision.
18. Trupi gjyqësor vëren se Komisioni ka garantuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke ia nënshtruar provat debatit edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit. Po ashtu, masa e shkarkimit nga detyra është marrë pas konstatimit se subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë dhe të cenimit të besimit të publikut, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016⁴, parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohen vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synojnë që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë dispozitë, parashikohet se subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime, me qëllimin për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit gjatë hetimit administrativ të kryer prej tij. Referuar gjetjeve të evidentuara nga

⁴ Neni 52 përcakton parime mbi barrën e provës. Pika 1 parashikon: "[...] Komisioni dhe Kolegi i Apelit, në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit [...]".

Komisioni, që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe në konstatimin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, është rrjedhojë direkte e parashikimeve ligjore. Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar në qëndrimin e shprehur për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016⁵. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të parimeve të kontradiktoritetit dhe proporcionalitetit, u gjet i pabazuar.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit për njëanshmëri të Komisionit në vendimmarrje, trupi gjykues, përveçse vëren se, gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka ngritur pretendime të kësaj natyre, nuk konstaton që në ankimin e paraqitur para Kolegjit, subjekti në mënyrë konkrete të ketë paraqitur fakte e prova në mbështetje të një pretendimi të tillë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen këtë pretendim të subjektit të pambështetur në fakte.
20. Subjekti ka pretenduar se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, alogjik, kontradiktor, bazuar në interpretime joobjektive, paragjyqese dhe tendencioze, në interpretim të gabuar të frymës dhe qëllimeve të procesit të rivlerësimit, si dhe standardeve ekonomike, fiskale kontabël e tregtare, si dhe nuk plotëson standardet e përcaktuara në vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese. Sipas subjektit, konsiderimi i provave për vitet 1985-2004, si të pamjaftueshme në vitin 2024, kur shumë institucione vendase dhe të huaja nuk ruajnë më dokumente, është i paarsyeshëm, i padrejtë dhe i pabazuar në ligj⁶.
21. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, lidhur me aspektin formal, trupi gjykues vëren se, referuar përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet qartë se teksti i tij përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga kjo dispozitë, si dhe rezulton në përputhje edhe me udhëzimet e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, pra me argumente logjike⁷, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje⁸. Për sa i përket pretendimit në lidhje me çmuarjen e provave, veçanërisht sa i takon analizës financiare të kryer në Komision, trupi gjykues konstaton se në vendimin objekt shqyrtimi, pasqyrohen të detajuara të ardhurat që janë marrë në konsideratë në analizën financiare, në përputhje me përcaktimet ligjore.
22. Trupi gjykues, në referencë të jurisprudencës së Kolegjit⁹, vlerëson se fakti që rezultati përfundimtar i Komisionit është i ndryshëm nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se ka munguar vlerësimi i provave, por se provat e sjella, pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, në këndvështrimin e tij, nuk kanë mundur të provojnë faktin për të cilin janë paraqitur. Ky vlerësim i provave sipas bindjes së brendshme të Komisionit, është në përputhje me atributet gjyqesore e vlerësuese që ky organ ka në këtë proces, sipas parashikimeve

⁵ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 34/2019 (JR), nr. 32/2019 (JR), nr. 28/2019 (JR), nr. 23/2019 (JR), nr. 22/2019 (JR) etj.

⁶ Subjekti ka cituar nenin 33 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin e pasurive", i ndryshuar, ku përcaktohet afati 10 vjet i ruajtjes së dokumentacionit që ka të bëjë me deklarimin dhe kontrollin e pasurive.

⁷ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.04.2012.

⁸ Shfaqur në vendimin nr. 28, datë 15.05.2014, të Gjykatës Kushtetuese.

⁹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 5/2019 (JR), nr. 13/2019 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 11/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 26/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR).



të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe në të njëjtën linjë me jurisprndencën e GjEDNJ-së, në qëndrimin e mbajtur në çështjen *Wierzbicki k. Polonisë*, viti 2002¹⁰.

23. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vendimi objekt shqyrtimi përmbush kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe nuk përmban të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit gjendet i pabazuar.
24. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të tij, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin¹¹ tashmë të konsoliduar në vendimmarrjet e Kolegjit në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi i secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe kontrollit të figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbejë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit.
25. Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka gëzuar të gjitha garancitë procedurale që lidhen me mundësinë për të dhënë shpjegime në përgjigje të pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit, është njohur me aktet e dosjes gjyqësore të administruara kryesisht nga Komisioni, për të cilën ka nënshkruar dhe deklaruar të njohjes me dokumentacionin e administruar nga Komisioni, si dhe ka pasur kohën e mjaftueshme për të paraqitur shpjegimet e tij dhe akte shkresore/prova, në përgjigje të barrës së provës.
26. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.
27. Në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, në kushtet kur nuk u evidentuan shkelje të rënda procedurale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar akte shkresore me ankimin, trupi gjykues vlerëson se nuk gjejnë zbatim parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, që do të legjitimonin gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit e, për rrjedhojë, vlerësohet që shqyrtimi i çështjes mund të bëhet në dhomë këshillimi, në bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji.

¹⁰ Neni 6 i Konventës nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën për të thirrur dëshmitarë apo për të paraqitur prova të tjera në gjykimet civile. Në lidhje me këtë, gjykata përsërit se vlerësimi i rëndësisë së provave për çështjet konkrete, është kompetencë e gjykatave të brendshme.

¹¹ Shih vendimet e juridiksionit të rivlerësimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit: nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19; nr. 3, datë 06.02.2023, paragrafi 12.20.



C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

28. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit tokë truall me sipërfaqe 240 m² dhe shtëpi banimi në vlerën 300.000 lekë, me sipërfaqe prej 123,3 m², të ndodhura në Shkodër, Komisioni, në vendimin e tij, ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar plotësisht blerjen e truallit në vitin 2001, ndërtimin e godinës së banimit në vitet 2002 – 2003, si dhe rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pikë 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.
29. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive. Në lidhje me pasurinë e llojit truall të blerë në vitin 2001, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka rritur në mënyrë artificiale vlerën e shpenzimeve të jetesës, si dhe nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga: (i) punësimi i subjektit për periudhën tetor 1986 – 1993 (4 vjet e 8 muaj, me pagë 520 lekë në vitin e parë dhe 630 lekë më pas); (ii) asistencë në masën 70% të pagës së mëparshme, sipas ligjit nr. 7521 datë 30.10.1991, "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", për periudhën 01.11.1991 – 01.11.1992; (iii) paga mujore 5.000 lekë, si përgjegjësi i Kadastrës për periudhën nëntor 1992 – mars 1993; (iv) shitja e bagëtive të përfituara nga shpërbërja e kooperativës, gjatë qëndrimit në fshat, deri në tetor të vitit 1995 (shitur 8-10 qengja çdo vit); (iv) bujqësia (prodhimi dhe shitja e 6.783 kg bimë medicinale timus 250–300 lekë/kg) për periudhën 1991–1995, në shumën 1.701.760 lekë.
30. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupë gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
31. Në deklaratën vetting, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.01.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Tokë truall në qytetin e Shkodrës, lagjja "{***}", me sipërfaqe prej 240 m², pasuria nr. {***}, ZK {***}, volumni {***}, faqe {***}, regjistruar në emër të bashkëshortes, E. S., blerë më datë 20.02.2001, kundrejt shumës prej 300.000 lekësh, me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2001. Pasuri e krijuar gjatë martesës 50% unë dhe 50% bashkëshortja. Të ardhurat janë siguruar nga puna ime si gjyqtar.*
32. Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie në vitin 2003, në seksionin "Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to", subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sip. 140 m², në qytetin e Shkodrës, me vlerë 3,5 milionë lekë, 50% pjesë takuese të pasurisë së llojit truall me sipërfaqe prej 240 m², ku është ndërtuar shtëpia e banimit, blerë nga bashkëshortja ime rreth vitit 2000 apo 2001, me vlerë prej 0,5 milion lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: Kursime, ndihma nga vëllezërit e mi në emigracion, që janë 3 në Gjermani, 2 në Itali, motra e gruas në Itali. Dërgesat – një pjesë janë bërë me Western Union.*
33. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se në datën 26.02.2001, është regjistruar në regjistrat hipotekorë me nr. {***}, ZK nr. {***}, në emër të bashkëshortes së



subjektit, znj. L. S., pasuria e llojit truall me sipërfaqe 240 m², i ndodhur në lagjen “{***}”, në Shkodër, bierë¹² në çmimin prej 500.000 lekësh.

34. Në përfundim të rezultateve të hetimit paraprak, nga analiza e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e truallit me sipërfaqe 240 m², të ndodhur në qytetin e Shkodrës, në shumën (-) 217.945 lekë.
35. Trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat e tij, të cilat kishin shërbyer si burim për krijimin e pasurisë së llojit truall dhe konstatoi se, në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti për periudhën 1986 - mars 1993, duhet mbajtur në konsideratë qëndrimi i tashmë i konsoliduar i Kolegjit¹³, sipas të cilit, për shkak të krizës së thellë financiare që kaloi vendi pas ndryshimeve të sistemit qeverisës, të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, konsiderohen të papërfillshme për efekt të vlerësimit të mundësisë së kursimit. Kjo për shkak të inflacionit ekstrem që arriti deri në 400%, duke pamundësuar akumulimin e të ardhurave të mjaftueshme për të përballuar shpenzime për pasuri me vlerë shumëfish më të madhe se të ardhurat vetjake.
36. Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga asistencja në periudhën 01.11.1991 – 01.11.1992, trupi gjykues vlerëson se bëhet fjalë për të ardhura minimale jetese, të cilat nuk mund të gjenerojnë kursime.
37. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e bagëtive dhe bimës medicinale timus, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dërguara pranë Komisionit, pas rezultateve të hetimit, ka paraqitur: (i) një vërtetim të datës 05.08.2024¹⁴, nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas të cilit, në periudhën 1993-1995, kjo shoqëri është furnizuar nga subjekti i rivlerësimit me bimën medicinale timus në vlerën totale prej 1.701.760 lekësh; (ii) një vërtetim¹⁵ nga Bashkia Malësi e Madhe, Njësia Administrative Shkrelë, ku referohet se pas ndarjes së kooperativave bujqësore në vitin 1991, z. Tonin Sterkaj ka përfituar 6.600 m² tokë, si dhe 15 krerë dele. Në këtë dokument, sqarohet gjithashtu se subjekti, deri në tetor të vitit 1995, kur është larguar nga fshati, ka zotëruar bagëti të ndryshme, si dhe është përcaktuar çmimi i shitjes për secilin lloj bagëtie në atë periudhë; (iii) një vërtetim¹⁶ nga Njësia Administrative Shkrelë, që lidhet me proceset e kultivimit të bimës medicinale timus dhe çmimet e shitjes së saj për vitin 1992.
38. Trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, vlerëson se të ardhurat e sipërpërshkruara nuk mund të konsiderohen si burim për blerjen e truallit në vitin 2001, pasi subjekti nuk i ka deklaruar si të tilla as në deklaratën e interesave privatë vjetorë/periodikë të vitit 2003, por i ka pretenduar vetëm pas njoftimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se, përpos distancës së gjatë kohore midis përfitimit të këtyre të ardhurave (1992-1995) dhe blerjes së truallit (në vitin 2001), mungesa e dokumentacionit ligjor për pagesën e

¹² Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 20.02.2001.

¹³ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 14, datë 09.07.2019.

¹⁴ Dokumenti nuk mban numër protokoll.

¹⁵ Vërtetim nr. {***} prot., datë 30.07.2024, paraqitur nga subjekti në prapësimet.

¹⁶ Vërtetim nr. {***} prot., datë 30.07.2024, paraqitur nga subjekti në prapësimet.

detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara, e vështirëson besueshmërinë e deklarimit të subjektit.

39. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka ngritur pretendime edhe në lidhje me shpenzimet e jetesës, duke pretenduar përlogaritjen e tyre për periudhën 1993 – 20.02.2001, në nivelin 30% - 40% të të ardhurave, pra në shumën 1.005.510 lekë, duke mbajtur në konsideratë edhe prodhimet bujqësore të familjes, si pjesë e shpenzimeve familjare.
40. Nga shqyrtimi i vendimit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka analizuar shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993-2001, dhe ka arritur në përfundimin se: *[...] janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit sa i përket reduktimit të shpenzimeve jetike për periudhën objekt analize, duke evidentuar edhe një herë se deri në vitin 1999, janë vlerësuar sa 66% e të ardhurave dhe se pas vitit 1999, sipas metodologjisë së ILDKPKJ-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it.*
41. Nga kontrolli i ushtruar ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se, për periudhën 1993-1999, shpenzimet e jetesës janë përlogaritur në masën 66% të të ardhurave nga paga. Trupi gjykues vëren se, në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, lidhur me metodologjinë e përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë, shpenzimet e jetesës duhet të konsiderohen në masën 30% të të ardhurave nga paga. Për pasojë, shpenzimet e jetesës për periudhën 1993 – 1999, nga 3.014.375 lekë reduktohen në 2.539.287 lekë. Nga rishikimi i analizës financiare mbi këtë bazë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë së llojit truall në vitin 2001, me çmimin 500.000 lekë.
42. Në lidhje me pasurinë “shtëpi banimi” në Shkodër, me sipërfaqe prej 123,3 m², të ndodhur në qytetin e Shkodrës, në drejtim të kohës së ndërtimit të saj, Komisioni ka konkluduar se: *Referuar dokumentacionit shkresor të administruar në dosjen e hetimit, pamjeve të marra nga burime të hapura, si dhe bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti, Komisioni arrin në përfundimin se pasuria objekt vlerësimi është ndërtuar në vitet 2002 – 2003. Ndërsa, në lidhje me koston e ndërtimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti sa i përket vlerës së ndërtimit të këtij objekti dhe rindërtimit të katit të tretë dhe çatisë, në këndvështrim të faktit se ndërtimi i këtij objekti, por edhe punimet e kryera për rindërtimin e shtesës, janë kryer në mënyrë informale, pra jo nga subjekte të licencuara dhe të regjistruara në organin tatimor, po t’i zbrisim vlerës së përlogaritur për ndërtimin dhe rindërtimin shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH + fitim + fond rezervë – vlera këto të përfshira në përlogaritjen e koston mesatare të ndërtimit (pra rreth 35% të saj) ¹⁷, shpenzimet e realizuara për ndërtimin e godinës së banimit objekt vlerësimi deri në vitin 2003, vlerësohen përfundimisht në shumën 6.516.785 lekë, ndërsa për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë në shumën 1.273.002 lekë.*
43. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar korrigjimin e analizës financiare, duke mbajtur në konsideratë se punimet kanë vijuar edhe pas vitit 2003 dhe se kostoja e ndërtimit duhet të

¹⁷ Komisioni referon paragrafin nr. 37 të vendimit të Kolegjit nr. 15/2019 (JR).

përlllogaritet sipas aktekspertimit të paraqitur prej tij¹⁸, në të cilin është mbajtur parasysh edhe fakti se ndërtimi është realizuar me ndihmën e familjarëve, si dhe fakti se kati përdhe (që shërben si garazh dhe magazinë) nuk ka të njëjtën kosto me sipërfaqet e banimit.

44. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi si vijon.
45. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sipërfaqe prej 123,3 m², ndërtuar në vitet 2002 – 2003, ndodhur në qytetin e Shkodrës, pasuria nr. {***}, ZK {***}, volumi {***}, faqe {***}, regjistruar në emër të bashkëshortes L. S., me vlerë 3.500.000 lekë – 4.000.000 lekë, pasuri e krijuar gjatë martesës 50% unë dhe 50% bashkëshortja¹⁹. Në ndërtimin e banesës, jam ndihmuar nga të afërmit e mi, prindërit, vëllezërit dhe kunati. Banesa është ndërtuar në periudhën kohore 2002-2003. Në datën 23.01.2004, kjo banesë është djegur dhe për rindërtimin e saj, subjekti është ndihmuar nga të afërm e kolegë.*
46. Po ashtu në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se: (i) vëllai i tij A. S. (me shtetësi gjermane) i ka dhuruar në fund të vitit 2002, shumën *cash* prej 6.000 eurosh; (ii) vëllai i tij A. B. (S.), edhe ai me shtetësi gjermane, i ka dhuruar në fund të vitit 2002, shumën *cash* prej 4.000 eurosh; (iii) kunati i tij, i ndjeri N. L., i cili ka jetuar në Itali që nga viti 1999, i ka dhuruar po në fund të vitit 2002, shumën 2.000 euro.
47. Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim "DIPP") të vitit 2013, në seksionin "Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit", subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi, ndërtuar në vitin 2003, me nr. {***}, deklaruar në vitin 2004, regjistruar në ZVRPP Shkodër më datë 19.07.2013, në emër të bashkëshortes, znj. L. S.*
48. I pyetur nga ILDKPKI-ja²⁰ lidhur me këtë pasuri (shtëpinë e banimit), subjekti ka deklaruar: *Në qershor të vitit 2002, kam filluar të ndërtoj shtëpinë dhe e kam përfunduar në vitin 2003. Banesa private është ndërtuar me kursimet ndër vite dhe ndihma e familjarëve emigrantë në shtete të ndryshme të Evropës. Tre vëllezër janë shtetas gjerman, dy vëllezër dhe një motër banojnë në Itali, një motër në Kanada. Bashkëshortja ime ka motrën e vet në Itali prej vitesh. Jam në marrëdhënie pune qysh prej vitit 1986. Në ndërtimin e banesës ka kontribuar edhe puna e babait tim, i cili ka punuar në ndërtim gjithë jetën e vet. Në janar të vitit 2004, shtëpia më është djegur dhe ndonjë dokument që mund të kem pasur aty, është djegur gjithashtu. Do komunikoj me familjarët për të siguruar dokumente ligjore provuese, për ndihmën e marrë prej tyre.*
49. Në datën 07.09.2006, nëpërmjet formularit "Vetëdeklarim për legalizimin", të dorëzuar Njesisë së Urbanistikës së Njesisë së Qeverisjes Vendore Shkodër, bashkëshortja e subjektit, znj. L. S., ka deklaruar pasurinë shtëpi banimi, e ndërtuar në datën 01.03.2003, me sipërfaqe të zënë 240 m², sipërfaqe ndërtimi 123,7 m², 3 kate mbi tokë. Të dhënat e kësaj pasurie përputhen me ato të përshkuara në aktin e kolaudimit të datës 07.12.2012. Në datën 04.05.2009, nga ALUZINI është gjeneruar taksa e ndikimit në infrastrukturë për këtë pasuri, duke u përlllogaritur vlera e

¹⁸ Me dërgimin e propozimeve pas rezultateve të hetimit administrativ, ka depozituar raportin e shoqërisë audituese "{***}" të datës 17.08.2024.

¹⁹ Subjekti ka cituar shkresën "Informacion mbi pasurinë" të ZVRPP Shkodër, me nr. {***}, datë 14.10.2016.

²⁰ Referoju dokumentit "Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive", i datës 22.10.2014, dërguar në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2024.

ndërtimit në shumën 11.038.784 lekë ($394,51 \text{ m}^2 \times 27.981 \text{ lekë} / \text{m}^2$). Në vitet 2009 dhe 2013, znj. S. ka kryer pagesat e tarifave për legalizimin e këtij objekti, në total në vlerën prej 128.387 lekësh. Në datën 21.01.2013, është lëshuar leja e legalizimit në emër të bashkëshortes së subjektit për këtë pasuri me sipërfaqe totale ndërtimi $394,51 \text{ m}^2$ dhe, në të njëjtën datë, pasuria është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të saj.

50. Në përgjigje të pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ndërtimi i shiëpisë së banimit është kryer në periudhën 2002 – 2003, dhe se ka filluar të banojë në këtë godinë prej muajit mars të vitit 2003. Sa i përket vlerës së investuar për ndërtimin e saj, ai ka deklaruar se ka qenë rreth 3.500.000 lekë – 4.000.000 lekë. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se deri në mars të vitit 2003, ka pasur të përfunduar pjesërisht banesën dhe kati përdhe/bodrumi ishte ende i papërshtatur tërësisht për banim. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se në periudhën qershor 2002 – shkurt 2003, ka shpenzuar rreth 2.000.000 lekë për materialet e ndërtimit dhe se punimet janë kryer pa pagesë nga persona të tij të afërt, të cilët kanë punuar në fushën e ndërtimit, por nuk disponon dokumentacion në lidhje me ndërtimin e banesës. Në ankim, subjekti ka parashtruar se: *Fakti se kam filluar që të banoj në këtë objekt së bashku me familjen që më datë 01.03.2003, nuk do të thotë asesi se ky ndërtim ka qenë i përfunduar në çdo zë punimesh, pasi një pjesë e tyre janë edhe sot e kësaj dite të papërfunduara e jo më në mars 2003. Kur kemi filluar të banojmë në të, kanë qenë të përfunduara së ndërtuari vetëm karabinaja, çatia, kuzhina, dhoma e fjetjes [...]. Ndërsa pjesët e tjera të banesës nuk kishin përfunduar.*
51. Për sa më sipër, lidhur me kohën e ndërtimit të pasurisë shtëpi banimi me sipërfaqe prej $123,3 \text{ m}^2$, e ndodhur në Shkodër, trupi gjyqës, bazuar në deklarin e subjektit në deklaratën e pasurisë vetting, deklarinet periodike të subjektit, shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ, deklarinet të tij në ILDKPKI në datën 22.10.2014, si dhe referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit të kryer nga Komisioni²¹, të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të depozituar pranë ALUZNIT e të nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit, e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo pasuri ka qenë e papërfunduar (karabina) në vitin 2003. Në këto kushte, trupi gjyqës e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se pasuria në analizë është ndërtuar në vitet 2002 – 2003.
52. Lidhur me koston e ndërtimit të pasurisë në analizë, trupi gjyqës konstatoi se, për përlogaritjen e saj, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, i është referuar koston së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim "EKB"), sipas udhëzimit nr. 1 datë 08.05.2003, duke arsyetuar, ndër të tjera, se²²: *[...] në kushtet kur duket se ndërtimi i këtij objekti është realizuar përgjatë viteve 2002 – 2003, si edhe nisur nga fakti se kostoja mesatare e ndërtimit e përcaktuar për qytetin e Shkodrës në udhëzimin e EKB-së për vitin 2003, është më e vogël se kostoja mesatare e ndërtimit e përcaktuar për gjithë territorin e Shqipërisë për vitin 2002, Komisioni do përlogarisë si kosto mesatare të ndërtimit për objektin e ndërtuar nga subjekti i rivlerësimit, koston e pasqyruar në udhëzimin e dalë për EKB-në të vitit 2003,*

²¹ Komisioni ka verifikuar fazat e ndërtimit në gjeoportalin "ASIG" dhe ka konstatuar se në foton e vitit 2001, në parcelën/truallin mbi të cilën është ngritur kjo ndërtesë, nuk ka evidentuar ndërtim. Ndërsa, nga një foto e muajit maj të vitit 2003, ka evidentuar ndërtuesin e përfunduar, përfshirë edhe pjesën e çatisë së këtij objekti.

²² Shih paragrafin nr. 43.1 të vendimit objekt shqyrtimi.

ku specifikohet kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës, 25.414 lekë/m². Në total, kosto e ndërtimit e përlogaritur nga Komisioni në rezultatet e hetimit, ka qenë 10.025.823 lekë.

53. Në vijim, pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit, në të cilat ai ka pretenduar se punimet janë kryer nga të afërmit dhe familjarët e tij, Komisioni ka arritur në përfundimin se²³: [...] në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti sa i përket vlerës së ndërtimit të këtij objekti dhe rindërtimit të katit të tretë dhe çatisë, në këndvështrim të faktit se ndërtimi i këtij objekti, por edhe punimet e kryera për rindërtimin e shtesës, janë kryer në mënyrë informale, pra jo nga subjekte të licencuara dhe të regjistruara në organin tatimor, po t'i zbresim vlerës së përlogaritur për ndërtimin dhe rindërtimin, shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH + fitim + fond rezervë – vlera këto të përfshira në përlogaritjen e koston mesatare të ndërtimit (pra rreth 35% të saj)²⁴, shpenzimet e realizuara për ndërtimin e godinës së banimit objekt vlerësimi deri në vitin 2003, vlerësohen përfundimisht në shumën 6.516.785 lekë, ndërsa për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë në shumën 1.273.002 lekë.
54. Trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit në raport me përfundimin e arritur nga Komisioni në lidhje me koston e ndërtimit, bazuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar sa u përket ndërtimeve informale për të cilat nuk provohet me dokumentacion të kohës kostoja reale e investimit²⁵, e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit që përlogaritja e investimeve të kryera për ndërtimin e shtëpisë së banimit objekt shqyrtimi, duhet të bëhet bazuar në çmimet e referencës të përcaktuara nga EKB-ja. Në përlogaritjen e koston së ndërtimit, Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2003, të EKB-së²⁶, duke përdorur koston mesatare të ndërtimit për qytetin e Shkodrës në masën 25.414 lekë/m², me arsyetimin se nuk mund të zbatohet kostoja e përcaktuar në udhëzimin e vitit 2002, pasi për atë vit, kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës, rezultonte jo vetëm më e lartë se ajo e vitit 2003, por edhe më e lartë se mesatarja kombëtare për vitin 2002. Trupi gjykues e gjeti të drejtë përlogaritjen e kryer nga Komisioni për koston përfundimtare të ndërtimit të sipërfaqes totale prej 394,5 m² në vlerën prej 6.516.785²⁷ lekësh, pasi janë zbritur nga vlera totale e ndërtimit TVSH-ja, fitimi dhe fondi rezervë në masën totale prej 35%.

²³ Shih paragrafin nr. 55.4 të vendimit objekt shqyrtimi.

²⁴ Komisioni referon paragrafin nr. 37 të vendimit të Kolegjit nr. 15/2019 (JR).

²⁵ Në mungesë të të dhënave të sakta lidhur me fazat e investimeve të kryera, situacionin e punimeve gjatë përtudhës së ndërtimit apo faturat për shpenzimet e kryera, si dhe për shkak se kemi të bëjmë me një ndërtim informal.

²⁶ Referuar udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave (EKB) për vitin 2002, kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës ka qenë 31.959 lekë/m², ndërsa kostoja mesatare për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ka qenë 29.201 lekë/m² (udhëzimi nr. 3, datë 16.10.2002). Ndërsa, bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 08.05.2003, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit "K", kosto mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës për vitin 2003, ka qenë në vlerën 25.414 lekë/m², Komisioni i është referuar çmimit të referencës së vitit 2003, i cili ka qenë më i vogël se ai i vitit 2002. Për vitin 2003, kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Shkodrës ka qenë 25.414 lekë/m², ndërsa kostoja mesatare për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ka qenë 30.867 lekë/m² (udhëzimi nr. 1, datë 08.05.2003).

²⁷ Sipërfaqja prej 394,5 m² e shumëzuar me koston mesatare të ndërtimit prej 25.414 lekësh, rezulton në vlerën 10.025.823 lekë. Kësaj shume i është zbritur TVSH-ja, fitimi dhe fondi rezervë në një masë të përgjithshme prej 35% dhe ka rezultuar vlera 6.516.785 lekë.



55. Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë shtëpi banimi me sipërfaqe prej 123,3 m², trupi gjykues konstaton se në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se për ndërtimin e banesës deri në vitin 2003 dhe rindërtimin e saj në vitin 2004, pas djegies, është ndihmuar nga të afërmit e tij, prindërit, vëllezërit dhe kunati. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer edhe të ardhurat e dhuruara nga: (i) vëllai i tij A. S., në shumën prej 6.000 eurosh; (ii) vëllai i tij, A. B. (S.) në shumën prej 4.000 eurosh; dhe (iii) kunati i tij (bashkëshorti i motrës) N. L., në shumën prej 2.000 eurosh.
56. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti: [...] ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e përfituara nga dhuruesi A. S., të cilat vlerësohen se janë të mjaftueshme për të mundësuar dhënien prej tij të shumës 6.000 euro. Ndërsa, për personat e tjerë të lidhur, A. S. dhe N. L., konkludohet se nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin prej tyre të të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e shumave të referuara si të dhuruara e, në këtë kontekst, shumat e pretenduara prej 4.000 euro dhe 2.000 euro nuk do të përfshihen në analizën përfundimtare financiare.
57. Në lidhje me shumën 6.000 euro, dhuruar nga vëllai i tij A. S., sikurse vërehet nga konkluzioni i arritur nga Komisioni në vendimin e tij, kjo shumë është përfshirë si e ardhur në analizën përfundimtare dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendime.
58. Në lidhje me shumën 4.000 euro, dhuruar nga vëllai i tij A. B. (S.), subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për sa kohë vëllai i tij nuk është subjekt rivlerësimi, ka detyrimin që të provojë mundësinë financiare të vëllait vetëm për shumën e dhënë hua, detyrim të cilin pretendon se e ka përmbushur duke depozituar dokumentacionin përkatës. Konkretisht, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., datë 12.11.2014, me anë të së cilës konfirmohet dhurimi i shumës prej 4.000 eurosh nga vëllai në fund të vitit 2002. Po ashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e vëllait nga paga në Gjermani për muajt tetor (paga 623 euro) dhe nëntor të vitit 2002 (paga 804 euro).
59. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se ai ka përmbushur barrën e provës lidhur me shumën 4.000 euro të dhuruar nga vëllai i tij, trupi gjykues vlerëson ky pretendim nuk gjen mbështetje në provat e administruara, në kuadër të analizës së kryer sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, trupi gjykues e bazon në konstatimin se të ardhurat e vëllait të subjektit për muajt tetor-nëntor 2002, për të cilat ai ka paraqitur dokumentacion, edhe sikur të merren në konsideratë në vlerë të plotë, pa zbritur shpenzimet minimale të jetesës, nuk rezultojnë të mjaftueshme për të justifikuar me burime të ligjshme shumën prej 4.000 eurosh, të pretenduar nga subjekti si të dhuruar nga vëllai në atë vit. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e kësaj shume në analizën financiare për vitin 2002, u gjet i drejtë dhe i bazuar.
60. Në lidhje me shumën prej 2.000 eurosh të deklaruar nga subjekti si dhuratë nga kunati i tij, i ndjeri N. L., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndodhet në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruesit, për shkak se ky i fundit ka ndërruar jetë në vitin 2011. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur certifikatën e vdekjes, dëshminë e trashëgimisë ligjore, si dhe një shikresë të Unionit



Financiar²⁸, sipas së cilës të dhënat mbi marrëdhëniet financiare ruhen vetëm për një periudhë të kufizuar kohore.

61. Trupi gjykues vlerëson se në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, barra e provës për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave mbetet mbi subjektin e rivlerësimit, i cili duhet të provojë jo vetëm ekzistencën e marrëdhënies së dhurimit, por edhe burimet e ligjshme të dhuruesit për të justifikuar krijimin e shumës së dhuruar. Pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit në rastin konkret, nuk u arrit të provohet sipas kërkesave të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
62. Ndonëse trupi gjykues mban në konsideratë vështirësitë objektive të krijuara nga fakti se dhuruesi ka ndërruar jetë dhe kohës së gjatë që ka kaluar, subjekti nuk ka paraqitur prova alternative, indicie financiare apo rrethana të tjera bindëse që të mundësojnë verifikimin e kapacitetit ekonomik të z. N. L. për të disponuar shumën prej 2.000 eurosh. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin e shumës së dhuruar dhe, për pasojë, kjo shumë nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare të tij.
63. *Në lidhje me rindërtimin e pjesës së djegur të banesës në datën 23.01.2004, në ankim subjekti ka pretenduar se vlera e kostos për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë duhet të ishte njëra nga vlerat e përlllogaritura në dy aktet e ekspertimit të paraqitura prej tij, duke pretenduar se: [...]* duke ulur vlerën e ekzagjeruar prej 1.958.464 lekësh, në 320.000 lekë ose së paku 707.287 lekë për rindërtimin e çatisë.
64. Trupi gjykues konstatoi se në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se: *Më datë 23.01.2004, banesa më është djegur. (Paraqes vendimin e datës 20.04.2004 të Prokurorisë së Rrethit Shkodër). Pas djegies, për rindërtimin, jam ndihmuar nga shumë njerëz. Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti ka depozituar vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2004, regjistruar për veprën penale të "Shkatërrimit të pronës me zjarr", parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal. Në aktin e ekspertimit të mbajtur në lidhje me këtë procedim penal, si edhe në tabelën fotografike përkatëse, referohet se është djegur kati i tretë i ndërtesës dhe një pjesë e çatisë.*
65. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *[...] Dëmet kanë qenë të konsiderueshme, pasi nga zjarri i rënë më janë djegur çatia, tavanet, rroba, shtretërit, dy rafta rrobash, një televizor, libra, dokumente, një magnetofon etj. Vlerën e dëmit nuk mund ta përcaktoj dot, por për ekonominë time familjare, dëmet kanë qenë të konsiderueshme. Për këtë ngjarje, jam pyetur nga shërbimet e policisë gjyqësore e kam dhënë deklaratime. Si atëherë, ashtu dhe sot, kam bindjen e plotë se ngjarja ka qenë aksidentale dhe për këtë shkak as nuk kam kërkuar e as nuk jam kompensuar nga ndonjë ent shtetëror. Për rindërtimin e banesës, jam ndihmuar nga shumë njerëz (familjarë të mi e të bashkëshortes sime që jetojnë brenda e jashtë shteti, të afërm, kolegë të punës, të njohur, miq, shokë, fond i veçantë nga Gjykata. Në dijeninë time, kemi pasur ndihma në vlerë monetare që*

²⁸ Ka depozituar gjatë hetimit administrativ shkresën e Unionit Financiar nr. {***} prot., datë 23.05.2024, në referim të së cilës evidentohet se ky institucion disponon të dhëna deri në 5 vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare.



na janë dërguar nëpërmjet shërbimit "Western Union" nga të afërm të mi e të bashkëshortes sime). Theksoj, nga këto ndihma, më janë dhuruar shuma të konsiderueshme vlerash monetare (si lekë, euro, dollarë) që ma kanë bërë shumë të lehtë rindërtimin e banesës pas djegies. Për vetë situatën psikologjike në të cilën ndodheshim, si dhe referuar së drejtës zakonore e traditës, as nuk kena kërkuar e as nuk kena mbajtur shënime në lidhje me këto ndihma. Më kanë ofruar ndihmë, më kanë bërë dhurata, por asnjëherë nuk më kanë dhënë hua. Ndihma ka qenë pa interes. [...] Në rindërtimin e banesës kanë shërbyer dhe të ardhurat nga puna ime. Theksoj se për rindërtimin e banesës, pas djegies, kemi punuar unë, bashkëshortja ime, babai im, të afërmit e mi (kushëriri E.S., kushëriri Z. P., kushëriri N. S.), të cilët kanë kryer punë specifike, si: shtrimin e pllakave, riparimin e instalimeve elektrike e hidraulike, lyerjen). Gjithashtu, kanë punuar dhe fëmijët tanë, të cilët, megjithëse të vegjël, kanë punuar sipas mundësive e aftësive në orët e pasdites, kur ktheheshin nga shkolla dhe në fundjava.

66. Bashkëlidhur pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, subjekti ka paraqitur dokumentacionin²⁹, nëpërmjet të cilit pretendon se provon vlerën e investimit të kryer pas dëmit të shkaktuar nga djegia në vitin 2004. Konkretisht, subjekti i referohet një aktekspertimi kontabël, ku kostoja e rikonstruksionit është përlogaritur në shumën 707.287 lekë, si dhe një aktekspertimi të hartuar nga inxhinieri F. E., ku kostoja e punimeve është përlogaritur në shumën 320.000 lekë.
67. Pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit, paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni, për përcaktimin e vlerës së rindërtimit, i është referuar marrëveshjes së datës 17.05.2006 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, "Për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim", ku përcaktohen peshat e zërave kryesorë të punimeve në vlerën totale të ndërtimit. Në këtë marrëveshje, zërat si: gërmimet me makineri (0,3%), struktura beton-arme (36,4%) dhe vendosja e hekur-betonit (7,7%), përbëjnë në total 44,4% të punimeve, të cilat janë vlerësuar si të paaplikueshme në rastin konkret, pasi rindërtimi pas zjarrit, ka konsistuar kryesisht në punime rifiniturash dhe vendosjen e çatisë, pa ndërhyrje strukturore. Mbi këtë bazë, Komisioni ka përlogaritur vlerën e rindërtimit për sipërfaqen prej 142,66 m², duke u mbështetur në koston mesatare të ndërtimit për qytetin e Shkodrës për vitin 2004 (udhëzimi nr. 1, datë 04.03.2004, i EKB-së) dhe duke aplikuar 55,6% të vlerës së punimeve. Në këtë mënyrë, vlera e rifiniturave dhe e çatisë është përlogaritur nga Komisioni në shumën 1.958.464 lekë.
68. Komisioni, pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit, i cili ka pretenduar se punimet janë kryer nga familjarët dhe të afërmit, ka vlerësuar se nga vlera prej 1.958.464 lekësh duhet të zbatohet dhe zbritja prej 35%, e cila përfshin komponentët, si: TVSH-në, fitimin dhe fondin rezervë. Në përfundim, vlera e pranuar nga Komisioni në vendim, për rindërtimin e katit të tretë të banimit dhe çatisë në vitin 2004, ka rezultuar 1.273.002 lekë.
69. Trupi gjykues vëren se dy aktet e ekspertimit të paraqitura nga subjekti, nuk janë hartuar në kohën e kryerjes së punimeve, por shumë vite pas ndodhjes së ngjarjes. Për rrjedhojë, ato nuk mbështeten në dokumentacion teknik dhe financiar të kohës, si: preventivë punimesh, fatura

²⁹ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.



blerjeje materialesh, kontrata sipërmarrjeje, situacione punimesh apo dokumente të tjera që do të mundësonin verifikimin e vlerave të pretenduara. Në këto kushte, përmbajtja e tyre përfaqëson një vlerësim hipotetik dhe jo konstatim të drejtpërdrejtë të kostove reale të përballuara nga subjekti.

70. Për sa më sipër, në mungesë të provave që do të justifikonin pretendimin e subjektit për shpenzimet e rindërtimit të katit të tretë dhe çatisë, si dhe në kushtet kur punimet janë kryer në mënyrë informale, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar përlllogaritjen e kryer nga Komisioni për rindërtimin e katit të tretë, bazuar në çmimet e referencës sipas EKB-së, si dhe duke aplikuar zbritjet e nevojshme.
71. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit për uljen e vlerës së investimit në shumën 320.000 lekë ose 707.287 lekë, rezulton i pabazuar në prova dhe nuk mund të merret në konsideratë për efekt të analizës financiare.
72. Lidhur burimet financiare për rindërtimin e banesës pas djegies, në ankim subjekti ka kundërshtuar përfundimin e arritur nga Komisioni për mungesë të burimeve të ligjshme, duke pretenduar se financimi i rindërtimit është siguruar nga të ardhurat e tij si gjyqtar, kursimet personale, si dhe ndihmat e dhuruara nga familjarë, miq dhe kolegë, përfshirë shumat monetare të ndryshme, duke përmendur edhe konkretisht dërgesat nëpërmjet "Western Union-it".
73. Trupi gjykues konstaton se në DIPP-në e vitit 2004 dhe në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti nuk ka deklaruar shpenzime për investimin e pretenduar.
74. Në lidhje me pretendimin e subjektit për kursime të mundshme nga pagat, trupi gjykues, nga verifikimi i deklarimit të subjektit në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, të vitit 2003, konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* për vitin 2003. Mungesa e deklarimit të gjendjes *cash* për këtë periudhë, e bën të pamundur marrjen në konsideratë të ndonjë vlere *cash* si burim financiar për shpenzimet apo investimet e kryera në vitet pasuese.
75. Në lidhje me shumat e pretenduara si dhurime, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të dëshmojë përfitimin e tyre përmes transaksioneve bankare apo "Western Union-it". Subjekti nuk ka përcaktuar ndonjë vlerë konkrete për këto të ardhura, ndaj nuk është e mundur të verifikohet burimi dhe sasia e tyre.
76. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues, ekzistencën e burimeve financiare të pretenduara për përballimin e kostos së rindërtimit të banesës. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson si të drejtë analizën e Komisionit lidhur me burimet financiare për punimet e rindërtimit.
77. Në përfundim të analizës për shkaqet e ankimit lidhur me pasurinë "shtëpi banimi 3-katëshe", e ndodhur në qytetin e Shkodrës, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për investimet e kryera deri në vitin 2003, në shumën (-) 5.388.961 lekë, si dhe për rindërtimin e katit të tretë dhe çatisë në vitin 2004, duke rezultuar me balancë negative në shumën (-) 947.833 lekë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.



78. Lidhur me pasurinë e llojit automjet të markës "Audi A 6"³⁰, me targë {***}, në vlerën 12.700 euro, Komisioni ka arritur në përfundim se: Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekti vlerësimi dhe pagesën e detyrimeve doganore në lidhje me të, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.
79. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se, si burim për krijimin e kësaj pasurie, kanë shërbyer huatë e marra nga z. Gj. M. (sipas kontratës noteriale të huasë, datë 01.04.2009) dhe z. A. N. S. (kontratë noteriale huaje, datë 30.03.2008³¹), si dhe të ardhurat në shumën 840.704 lekë, të përshkruara si "të ardhura të trashëguara", të evidentuara në aktin e ekspertit kontabël të paraqitur prej tij, në të cilin kjo shumë rezulton si balancë pozitive në vitin 2008. Sipas subjektit, ndryshimi i qëllimit të përdorimit të huave, si dhe mospasqyrimi i saktë i destinacionit të tyre në deklaratën periodike të vitit 2010, përbën një pasaktësi formale, e cila nuk ndikon në analizën financiare, për sa kohë huaja është deklaruar saktësisht në deklaratën vetting.
80. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
81. Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë automjet në vlerën 12.700 euro, dhe, si burim krijimi, ka deklaruar: (i) hua nga z. Gj. M. sipas kontratës së huasë, datë 01.04.2009; (ii) hua nga z. A. N. S. sipas kontratës së huasë, datë 30.03.2008. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se burimi i të ardhurave për likuidimin e huasë ndaj z. A. S., më datë 27.02.2015, kanë qenë kursimet e krijuara nga të ardhurat e siguruar prej shitjes së bimës së shërbelës dhe pagës si gjyqtar.
82. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar blerje auoveture "Audi A6", me targë {***}, në vlerën 12.700 euro, pjesa takuese 100%. Në seksionin "Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë", subjekti ka deklaruar: i) kontratë huaje nr. {***} rep., {***} kol., datë 01.04.2009, kundrejt z. Gj. M., në shumën 1.400.000 lekë, me afat shlyerje 7 vjet, pa interes, pa shlyer; dhe ii) kontratë huaje nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 30.03.2009, kundrejt z. A. N. S., në shumën 800.000 lekë, pa interes, me afat shlyerje 6 vjet, e pashlyer.
83. Në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin "Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë", subjekti ka deklaruar: i) Hua për mjekimin tim. Vlera 1.400.000 lekë, pa interes, me afat shlyerjeje 7 vjet. Fillimi në datën 21.03.2009, mbarimi në datën 21.03.2016. ii) Hua për nevoja familjare, në vlerën 800.000 lekë, pa interes, me afat shlyerjeje 6 vjet. Fillimi në datën

³⁰ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor me nr. {***} prot., datë 03.02.2021, ka konfirmuar se subjekti ka pasur të regjistruar automjetin e markës "Audi A6", vit prodhimi 2005, me targë {***}, i cili më parë ka mbajtur targën {***}. Ky automjet është blerë në datën 25.03.2009³⁰ në Gjermani, në vlerën 12.700 euro dhe, në datën 04.04.2009, subjekti ka paguar detyrimin doganor, në total në shumën prej 446.306 lekësh.

³¹ Subjekti ka pretenduar që huaja është marrë në vitin 2009. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti e ka deklaruar huanë të marrë në vitin 2009. Në vitin 2015, si dhe në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti e ka deklaruar huanë të marrë në vitin 2008.



22.03.2009, mbarimi në datën 22.03.2015. Në seksionin "Të dhëna konfidenciale", ka deklaruar huadhënësit, përkatësisht z. GJ. M. dhe z. A. S. dhe kontratat e huaje.

84. Në DIPP-të e viteve pasuese, deri në vitin 2014, për çdo vit subjekti ka deklaruar: i) gjendje e pashlyer e huasë për mjekim, në shumën 1.400.000 lekë; dhe ii) gjendje e pashlyer e huasë për nevoja familjare, në shumën 800.000 lekë.
85. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: i) gjendje e pashlyer e huasë për mjekim, në shumën 1.400.000 lekë; dhe ii) më datë 11.07.2015, shlyer huanë e marrë nga shtetasi A. N. S. më datë 30.03.2008, 800.000 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për likuidimin e huasë³².
86. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka vijuar të deklarojë huanë në shumën 1.400.000 lekë të marrë për mjekim nga GJ. M. në datën 01.04.2009.
87. Gjatë hetimit administrativ³³, subjekti ka shpjeguar se dy huatë e sipërcituara janë marrë me qëllim mbulimin e shpenzimeve mjekësore të cilat do të kryheshin prej tij në Gjermani, ndërhyrje e cila nuk u krye, dhe shuma e marrë hua u përdor për blerjen e automjetit të markës "Audi A 6", në Gjermani. Po ashtu, subjekti ka deklaruar³⁴: Shtetasin A. N. S. e kam kushëri, Shtetasin GJ. LL. M. e njoh që në fëmijërinë time, pasi jemi nga e njëjta zonë (Malësi e madhe). Familjarisht kemi marrëdhënie miqësore. Ky shtetas është nuni i djallit tim, K. [...]. Fillimisht sqaroj se borxhin ua kam marrë të lartpërmendurve, personalisht, e jo subjekteve që ata mund të përfaqësojnë pasi kam menduar se kanë të ardhura të mjaftueshme financiare, për të më ndihmuar, kështu ka rezultuar. [...] Ky borxh është shlyer nga ana ime në vitin 2018 [...]. Në fakt, qëllimi im për marrjen e borxhit ka qenë për arsye shëndetësore. Duke qenë në dijeni të faktit se dhe mund t'i nënshtrohesh ndërhyrjes kirurgjikale, përpara se të nisesh për në Gjermani, kam marr borxh (hua) të shtetasi GJ. LL. M. shumën prej 1.400.000 lekësh e të shtetasi A. N. S. shumën prej 800.000 lekësh. Një pjesë nga kjo shumë, e konkretisht shumën prej 1.800.000 lekësh, i kemi konvertuar në euro dhe një pjesë të këtyre parave i kam mbajtur unë e një pjesë bashkëshortja ime [...] vendosa që më mirë të vuaj e të duroj dhimbjet e, për këtë arsye, nuk pranova të bëj ndërhyrjen kirurgjikale. Më pas, meqenëse nuk kisha mjet në pronësi, me paratë e marra borxh, bleva mjetin autoveturë të markës "Audi A 6" [...] Huadhënësit e kanë pasur të qartë qëllimin e dhënies së këtyre vlerave monetare [...] Afati i shlyerjes së borxhit është lënë i gjatë, pasi, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk kisha siguri nëse do ta shlyeja vetë apo do ua lëja si detyrim familjarëve të mi. Më pas, me huadhënësit kam pasur kontakte, kam biseduar me ta, prej tyre kam gjetur dakordësinë për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të shumave të marra hua, kam gjetur mirëkuptimin e tyre për shtyrjen e afatit për kthimin e borxhit [...].
88. Nga aktet në fashikujt e Komisionit, rezultoi se në datën 30.03.2008, subjekti ka nënshkruar kontratën e huasë³⁵ me z. A. S., për dhënien hua të shumës 800.000 lekë në datën 22.03.2009,

³² Subjekti ka depozituar dokumentin, deklarata noteriale (për përmbushje të detyrimit kontraktor) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.07.2015.

³³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

³⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

³⁵ Kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2008, redaktuar nga noteri publik, z. V. M.

jashtë zyrës noteriale, për një afat 6-vjeçar pa interes. Kjo shumë do të likuidohet përmes gjashtë kësteve që do të paguheshin nga subjekti në muajin dhjetor të çdo viti. Ndërsa, kësti i fundit do të likuidohet në datën 22.03.2015⁸⁶. Në datën 01.04.2009, subjekti ka nënshkruar kontratën⁸⁷ me z. GJ. M. për dhënie e huasë në vlerën prej 1.400.000 lekësh, në datën 21.03.2009, jashtë zyrës noteriale, për një afat 7 vjet (nga data 21.03.2009 deri në datën 21.03.2016), pa interesa në rast vonese të kthimit të huasë. Për të vërtetuar shlyerjen e huasë së marrë nga z. GJ. M. në vitin 2009, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit dy urdhër-transferta bankare të datave 23.03.2018 dhe 31.12.2018, në shumat 900.000 lekë dhe 500.000 lekë. Në të dy urdhër-transferta është përcaktuar si qëllim "likuidimi i huasë së marrë nga GJ. M. në vitin 2009", duke u pasqyruar njëkohësisht edhe numri përkatës i kontratës së huasë. Ndërsa, nga verifikimi i ekstraktit bankar të subjektit, konstatohen dy transfertat në favor të GJ. M., respektivisht në shumën 900.000 lekë dhe 500.000 lekë, por në ekstraktin bankar nuk është pasqyruar përshkrim lidhur me qëllimin e transaksioneve.

89. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka ngritur dyshime mbi ekzistencën reale të marrëdhënieve të huamarrjes (bazuar në faktet se: kontratat e huasë janë përpiluar disa ditë pasi subjekti ka blerë automjetin, si dhe nuk janë respektuar modalitetet e përcaktuara në këto kontrata sa i takon likuidimit të huave; ka ndryshuar destinacioni i përdorimit të huave) dhe, rrjedhimisht, nuk i ka konsideruar si burime të ligjshme për krijimin e pasurisë automjet. Ndërsa, konkluzioni përfundimtar i Komisionit lidhet vetëm me mungesën e burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi dhe pagesën e detyrimeve doganore në lidhje me të.
90. Për rrjedhojë, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti lidhur me burimin e ligjshëm të huadhënësve për mundësimin me të ardhura të ligjshme të huave të deklaruar nga subjekti dhe konstatoi sa vijon.
91. Lidhur me huadhënësin A. S., subjekti ka paraqitur vetëm ekstraktin e regjistrit tregtar⁸⁸ për shoqërinë "(***)" ShPK, në të cilin ky shtetas rezulton administrator dhe aksioner me 50% të aksioneve. Po ashtu, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale⁸⁹, lëshuar nga A. S. në datën 16.08.2024, me anë të së cilës konfirmohet dhënia e huasë në vitin 2009 në shumën 800.000 lekë, e financuar nga të ardhurat e tij personale të krijuara ndër vite, jashtë biznesit, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me këto të ardhura. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit lidhur me aftësinë financiare të huadhënësit, mbeten të pambështetura në dokumentacion ligjor. Ndërsa, për huadhënësin GJ. M., subjekti ka paraqitur ekstrakte⁹⁰ të llogarive të tij në banka të ndryshme, një deklaratë të thjeshtë të datës 24.05.2024, me anë të së cilës huadhënësi rikonfirmon dhënie e huasë në vitin 2009 dhe kthimin e saj në vitin 2018, një deklaratë noteriale⁹¹ të datës 15.08.2024, me anë të cilës z. GJ. M. ka deklaruar

⁸⁶ Në mëshjetje të deklaratësve të tij, subjekti ka depozituar dokumentin "Deklaratë noteriale" (për përmbushje të detyrimit kontraktor) nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.07.2015.

⁸⁷ Kontratë huaje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 01.04.2009, redaktuar nga noteri publik, z. P. Z.

⁸⁸ Kontratë huaje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30.03.2008, redaktuar nga noteri publik, z. V. M.

⁸⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr.2.

⁹⁰ Lëvizjet e llogarisë bankare pranë BKT në emër të z. GJ. M.; lëvizjet e llogarisë bankare për periudhën 2008-2009 pranë Procredit Bank, në emër të z. GJ. M.; lëvizjet e llogarisë bankare për vitin 2008 pranë Procredit Bank në emër të z. G. dhe z. GJ. M.

⁹¹ Kontratë huaje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 01.04.2009, redaktuar nga noteri publik, z. P. Z.



se në vitin 2009 i ka dhënë borxh subjektit shumën 1.400.000 lekë, të cilën e ka marrë nga vëllai i tij G. M. (nga aktiviteti i tij në fushën e ndërtimit). Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të z. M., rezultoi se gjatë vitit 2008, ai ka përfutur gjithsej 12 paga në vlerën totale prej 621.252 lekësh, shumë e cila nuk mjafton për të mbuluar vlerën e huasë së pretenduar të dhënë në vitin 2009.

92. Trupi gjykues çmon se, për të konsideruar një hua si burim të ligjshëm për krijimin e një pasurie, nuk mjafton vetëm ekzistenca formale e kontratës së huasë apo deklaratimet e palëve për ekzistencën e marrëdhënies juridike, por kërkohet që subjekti i rivlerësimit të provojë, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si ekzistencën reale të marrëdhënies së huamarrjes, ashtu edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit në momentin e dhënies së shumës së pretenduar.
93. Në rastin konkret, subjekti ka pretenduar se blerja e automjetit tip "Audi A6", me vlerë 12.700 euro, është financuar nga dy hua të marra nga shtetasit GJ. M. dhe A. N. S., si dhe nga një balancë pozitive prej 840.704 lekësh, e cilësuar si "të ardhura të trashëguara". Megjithatë, trupi gjykues çmon se këto pretendime nuk mbështeten nga prova të plota dhe bindëse, për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet burimeve të pretenduara dhe investimit të kryer.
94. Në këtë optikë, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për huadhënësin A. S., (ekstrakti i regjistrit tregtar të shoqërisë ku ai rezulton ortak dhe administrator, si dhe një deklaratë noteriale e vitit 2024) nuk provon krijimin e shumës 800.000 lekë në kohën e dhënies së huasë. Në mungesë të provave mbi të ardhurat, kursimet apo likuiditetet e tij në vitin 2009, pretendimi mbi aftësinë financiare të këtij huadhënësi, mbetet i paprovuar.
95. Po kështu, edhe për huadhënësin GJ. M., dokumentacioni i paraqitur nuk provon, sipas standardit të kërkuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, justifikimin me burime të ligjshme financiare të huadhënësit për shumën e dhënë hua prej 1.400.000 lekësh. Kjo pasi nga verifikimi i llogarive bankare të huadhënësit, trupi gjykues konstaton se të ardhurat e përfutura prej tij gjatë vitit 2008, kanë qenë në vlerën totale 621.252 lekë, shumë dukshëm më e ulët se vlera e huasë së pretenduar edhe pa zbritur prej saj shpenzimet për jetesë. Ndërsa deklaratat e mëvonshme të huadhënësit, sipas të cilave të ardhurat janë siguruar nga vëllai i tij, trupi gjykues i çmoi pa efekt në analizën e mësipërme, për sa kohë ato nuk u shoqëruan me dokumentacion justifikues.
96. Sa i takon shumës 840.704 lekë të evidentuar si balancë pozitive dhe të cilësuar si "të ardhura të trashëguara", në kuptim të mbartjes së balancave pozitive të viteve paraardhëse, të konstatuara nga ekspertit kontabël i caktuar prej tij, trupi gjykues, nga kontrolli i ushtruar mbi analizën e kryer nga Komisioni, vëren se, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në vitin 2009, analiza për verifikimin e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, është kryer për periudhën nga data 01.01.2009 deri në datën e blerjes dhe zhdoganimit, 04.04.2009. Në përfundim, trupi gjykues e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisionit se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën (-) 2.158.053 lekë.
97. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për financimin e blerjes së automjetit

"Audi A6", në vlerën 12.700 euro, si dhe likuidimin e detyrimeve doganore të lidhura me të në vitin 2009, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit mbi mungesën e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, rezulton i drejtë dhe i mbështetur në prova.

98. Lidhur me pasurinë e llojit tokë bujqësore me sip. 6.300 m², si dhe pasurinë e llojit shtëpi banimi njëkatëshe, me sip. 90 m², të ndodhura në fshatin D., Malësi e Madhe, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] ligjërisht subjekti nuk mund të përfitonte tokë bujqësore veçmas si kryetar i familjes bujqësore, pasi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 17.07.1991, "Për tokën", dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ai përfitonte pjesë takuese si anëtar i familjes ku bënte pjesë i regjistruar në certifikatën familjare në datën 1.8.1991. Gjithashtu, edhe në rastin e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore të xhaxhait të subjektit, të ndjerit V. S., subjekti ligjërisht nuk do të ishte trashëgimtar i radhës së parë dhe as i radhës së dytë, e aq më tepër të ishte trashëgimtar i vetëm. Në rast hipotetik, ai do të ishte trashëgimtar i radhës së tretë me zëvendësim, së bashku me vëllezërit dhe motrat e tij, nëse prindërit e tij do të kishin ndërruar jetë.
99. Deklarimi i këtyre pasurive në vite nga subjekti i rivlerësimit, paraqitet si vijon.
- Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti e ka deklaruar: (i) pasuri e llojit tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.300 m² dhe tokë truall me sipërfaqe prej 300 m², të ndodhura në fshatin D., Malësi e Madhe; (ii) shtëpi banimi e ndodhur në fshatin D., Malësi e Madhe, me të dhënat përkatëse dhe rrethanat e përfitimit të saj, duke referuar se është në procedura regjistrimi – përfshirë dhe çeljen e dëshmisë së trashëgimisë.
 - Në deklaraten vetting, subjekti ka deklaruar: (i) shtëpi banimi njëkatëshe, e përbërë nga dy dhoma, korridor dhe verandë me sipërfaqe 90 m², e ndodhur në fshatin D., Komuna SH., Malësi e Madhe, ndërtuar në vitin 1977 nga xhaxhai im i ndjerë V. GJ. S. Kam qenë i falun tek ai sipas zakonit (kam jetuar me të qëkur kam qenë 6 muajsh), por pa ndryshuar atësi e amësi; (ii) tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.300 m² në fshatin D., Malësi e Madhe, fituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. {***}, datë 07.01.2011, pasi në vitin 1991 kam qenë zyrtarisht banor i fshatit [...]. Bashkëlidhur deklaratës vetting, subjekti ka paraqitur një vërtetim me nr. {***} prot., datë 17.03.2011, nga Komuna Shkrel, si dhe një vërtetim me nr. {***}, datë 21.10.2016, nga Njësia Administrative Shkrel (Bashkia Malësi e Madhe), ku evidentohet se subjekti i rivlerësimit, ish-banor në fshatin D. të Njesisë Administrative Shkrel, ka jetuar që nga lindja e tij me xhaxhain, V. S., i cili nuk ka pasur fëmijë, në shtëpinë e tij njëkatëshe, e cila ndodhet në fshatin D. të Njesisë Administrative Shkrel, e ndërtuar në vitin 1977, me sipërfaqe rreth 90 m², mbi tokën bujqësore – duke referuar AMTP-në përkatëse⁴² që i bashkëngjitet vërtetimit. Po ashtu, subjekti ka paraqitur AMTP-në me nr. regjistri {***}, datë 07.01.2011, për dhënien në pronësi të sipërfaqes prej 6.600 m² tokë familjes së tij, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën".
100. Subjekti ka pretenduar në ankim se pasuritë: tokë me sip. 6.300 m², shtëpi banimi njëkatëshe me sipërfaqe 90 m², i ka përfituar sipas së drejtës zakonore (si fëmijë "i falur" të xhaxhai V.

⁴² Nga të cilat: (1) me vendndodhje ngastre në "{***}" 5.000 m²; (2) me vendndodhje ngastre "{***}" 1.000 m²; dhe (3) me vendndodhje ngastre "kopshti të shtëpia" 600 m², ku 300 m² referohen se janë truall.



S.) dhe se organet shtetërore kishin gjetur një mënyrë për t'ia kaluar në pronësi me AMTP-në në emër të tij, në datën 07.01.2011, vetëm për tokën bujqësore që posedon faktikisht dhe vetëm për sipërfaqen e tokës bujqësore.

101. Gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentin vërtetim nr. {***} prot., datë 22.05.2024, të Njesisë Administrative Shkrel (Bashkia Malësi e Madhe), në referim të të cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka përfitur tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, me sipërfaqe 6.600 m², nga të cilat 300 m² janë truall dhe pjesa tjetër tokë e llojit arë. I pyetur nga Komisioni mbi mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive⁴³, subjekti ka deklaruar se e ka përfitur atë me AMTP dhe se ka qenë banor i fshatit D.
102. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se edhe babai biologjik i subjektit ka përfitur pasuri me AMTP, për të cilat subjekti nuk ka deklaruar të drejtat reale as në deklaratat e interesave privatë pasuror dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *vetting*. Subjekti ka shpjeguar se secili nga banorët e fshatit ka marrë tokë sipas kufijve të vjetër e jo sipas normës për frymë. Gjithashtu, subjekti sqaron se, për pasuritë e prindërve të tij biologjikë, nuk është çelur dëshmi trashëgimie. Në datën 26.07.2024, subjekti ka nënshkruar deklaratën noteriale "Për heqjen dorë nga trashëgimia"⁴⁴, duke hequr dorë nga të gjitha të drejtat e tij reale pasurore që trashëgon nga prindërit e tij biologjikë.
103. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues çmon se mënyra e përfitimit dhe e posedimit të pasurive të deklaruara duhet të analizohet jo vetëm në raport me kriterin e pasurisë, por edhe në funksion të vlerësimit të mundshëm të cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër, vlerësimi i sjelljes së subjektit duhet të mbështetet në një analizë të plotë të rrethanave faktike dhe juridike të çështjes, duke respektuar standardin e provueshmërisë, të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
104. Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti ka deklaruar se pasuria tokë me sipërfaqe 6.300 m² dhe shtëpia e banimit njëkatëshe me sipërfaqe 90 m² janë përfitur sipas së drejtës zakonore, për shkak të statusit të tij si fëmijë "i falur" të xhaxhai V. S. Nga ana tjetër, dokumentacioni i paraqitur gjatë hetimit administrativ, konkretisht vërtetimi nr. {***} prot., datë 22.05.2024, i Njesisë Administrative Shkrel, pasqyron se subjekti ka përfitur tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, me sipërfaqe totale 6.600 m², nga të cilat 300 m² truall dhe pjesa tjetër tokë arë. Po kështu, vetë subjekti ka deklaruar para Komisionit se pasurinë e ka përfitur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi dhe se ka qenë banor i fshatit D.
105. Në aspektin juridik, trupi gjykues vëren se ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", parashikonte shpërndarjen e tokës bujqësore për familjet bujqësore që ishin banorë të fshatit në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga komisionet përkatëse të ndarjes së tokës. Përfitimi i tokës në bazë të këtij ligji, lidhej me ekzistencën e statusit të anëtarit të familjes bujqësore dhe jo me institutet e së drejtës zakonore.

⁴³ Në pyetësoin nr. 3.

⁴⁴ Me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka depozituar pranë Komisionit "Deklaratë për heqjen dorë nga trashëgimia" me nr. {***} rep. nr. {***}8 kol., datë 26.07.2024.



Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se posedimi i pasurisë lidhet me statusin e tij si fëmijë "i falur" të xhaxhai, nëse do të konsiderohej si bazë juridike e vetme e përfitimit, do të paraqiste paqartësi në raport me kërkesat e ligjit nr. 7501/1991 dhe, për më tepër, nuk harmonizohet me dokumentacionin zyrtar të administruar në dosje, i cili referon përfitimin e saj nëpërmjet AMTP-së. Kjo mospërputhje nuk lidhet thjesht me një pasaktësi terminologjike, por me vetë bazën juridike të fitimit të pasurisë.

106. Nga analiza e provave të administruara, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka arritur të japë një shpjegim të qartë, të qëndrueshëm dhe bindës për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, pasi deklaratimet e tij vijnë në kundërshtim me aktet mbi bazën e të cilave është përfituar kjo pasuri. Edhe pse nuk rezulton të ketë një akt administrativ apo gjyqësor që të ketë konstatuar pavlefshmërinë e AMTP-së ose paligjshmërinë e përfitimit të tokës, deklaratimet e ndryshme të subjektit mbi të njëjtën rrethanë faktike, krijojnë paqartësi lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë prej tij gjatë procesit të rivlerësimit.
107. Në vlerësimin e kriterit të pasurisë, jurisprudenca e Kolegjit ka theksuar se besueshmëria e subjektit përbën një element thelbësor të analizës, pasi procesi i rivlerësimit mbështetet jo vetëm në dokumentacionin provues, por edhe në deklaratimet dhe shpjegimet që subjekti jep për rrethanat që lidhen me pasuritë e tij. Sipas kësaj jurisprudence, për të arritur në përfundimin se një subjekt ka cenuar besimin e publikut, kërkohet ekzistenca e fakteve konkrete dhe e rrethanave të provuara që evidentojnë një sjellje të papajtueshme me standardet etike dhe ligjore që burojnë nga funksioni i magjistratit, si dhe një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet kësaj sjelljeje dhe ndikimit negativ që ajo prodhon në perceptimin e publikut për integritetin, paanshmërinë dhe ligjshmërinë e sistemit të drejtësisë.
108. Duke iu rikthyer rrethanave të faktit, trupi gjykues çmon se mospërputhjet e konstatuara ndërmjet deklaratimeve të subjektit dhe dokumentacionit zyrtar, si dhe mungesa e një shpjegimi të qëndrueshëm për raportin ndërmjet pretendimit për përfitim sipas së drejtës zakonore dhe përfitimit të pasurisë nëpërmjet AMTP-së, nuk mjaftojnë për të konkluduar mbi ekzistencën e një përfitimi të provuar në kundërshtim me ligjin, por ato ndikojnë negativisht në vlerësimin e besueshmërisë së subjektit në kuadër të kriterit të pasurisë, pasi evidentojnë mungesë koherence, transparence dhe saktësie në deklaratimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit. Po kështu, fakti që subjekti nuk ka deklaruar të drejtat e mundshme trashëgimtare mbi pasuritë e prindërve biologjikë, duke ndërmarrë heqjen dorë nga trashëgimia vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, përbën një tjetër element që shton dyshimet mbi plotësinë dhe saktësinë e deklaratimeve të tij.
109. Megjithatë, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se jo çdo parregullsi, pasaktësi apo paqartësi në administrimin e pasurisë përbën automatikisht cenim të besimit të publikut. Përkundrazi, kërkohet që sjellja e subjektit të jetë e tillë sa të krijojë bindjen se magjistrati ka vepruar në kundërshtim me ligjin ose me standardet e integritetit që priten prej tij. Në këtë kuptim, cenimi i besimit të publikut nuk mund të prezumohet, por duhet të rezultojë nga një analizë objektive e fakteve të provuara.
110. Në rastin konkret, trupi gjykues, në konsideratë të shpjegimeve të subjektit lidhur me rrethanat familjare dhe zakonore të posedimit të pasurisë, ndonëse jo plotësisht të harmonizuara me

dokumentacionin administrativ që referon përfitimin sipas ligjit nr. 7501/1991, si dhe në mungesë të provave që të vërtetojnë se subjekti ka ushtruar ndikim të paligjshëm mbi organet kompetente, ka manipuluar procedurat administrative apo ka kryer veprime që të evidentojnë mungesë integriteti, arrin në përfundimin se faktet e evidentuara nuk mjaftojnë për të arritur në përfundimin se ai ka vepruar me dashje për të fshehur të vërtetën ose për të përfituar këtë pasuri në kundërshtim me ligjin.

111. Për rrjedhojë, ndonëse mënyra e përfitimit dhe e dokumentimit të pasurisë paraqet elemente paqartësie që kërkojnë vlerësim në kuadër të kriterit të pasurisë dhe të saktësisë së deklarimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se rrethanat e konstatuara nuk mbështesin konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe standardeve të zhvilluara nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
112. Në lidhje me detyrimin për deklarimin e pjesëve takuese të pasurisë nga subjekti, trupi gjykues vëren se, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991, "Për tokën", përfitonin tokë familjet bujqësore, ku secili anëtar i saj, pjesë e certifikatës familjare, datë 01.08.1991, zotëronte të drejta reale/pjesë takuese si bashkëpronar mbi këtë pasuri, pavarësisht moshës. Referuar akteve të administruara në dosjen e hetimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në datën 01.08.1991, ka qenë pjesë në certifikatë familjare së bashku me familjen biologjike të tij (ku si kryetar i familjes bujqësore shfaqet babai i tij), si banues në fshatin D., Malësi e Madhe.
113. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 84/2016, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin në deklaratën *vetting*, të pjesëve të tij takuese të pasurive në pronësi të prindërve biologjikë, të cilat *de jure* i posedonte⁴³, pavarësisht gëzimit ose jo të tyre, sikurse edhe ka vepruar në vijim, përmes deklaratës së sipërpërshkruar, për heqjen dorë nga pjesa takuese mbi këtë pasuri, veprim i cili duhet të ishte kryer prej tij në momentin e nxjerrjes së AMTP-së së datës 07.01.2014 – duke shmangur në këtë mënyrë pasaktësitë në deklaratimet periodike, por veçanërisht pasojat që burojnë nga mosdeklarimi në deklaratën *vetting*, i të drejtave reale mbi pasurinë e përfituar si pjesë e familjes bujqësore.
114. Në lidhje me faktin e mosdeklarimit të pjesës takuese mbi pronësinë e tokës bujqësore të përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 17.07.1991, "Për tokën", për të cilën është lëshuar AMTP-ja në emër të babait të tij biologjik, si kryetar i familjes bujqësore, në mungesë të dyshimeve mbi burimin e ligjshëm të krijimit të saj, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi nuk përbën shkak për vlerësim negativ për efekt të këtij procesi, për shkak se kemi të bëjmë me pasuri të përfituar me ligj.
115. Në lidhje me investimin e kryer në banesën e ndodhur në fshatin D., Malësi e Madhe, për të cilin Komisioni ka ngritur dyshime për ndërtimin e një kati shtesë, si dhe një godine të re, ngjitur me banesën ekzistuese, subjekti ka parashtuar në ankim se nuk ka pasur shtesë të kateve, por riparim çatie në vitin 2023, nga djali i tij, K. S. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se pas shtëpisë me sip. 90 m², ka ekzistuar një objekt që është përdorur fillimisht si kasolle për

⁴³ Në kuptim të nenit 304 të Kodit Civil.



bagëti e, më pas, si magazinë ku kanë ruajtur bimët medicinale që kanë mbjellë ndër vite derisa kanë gjetur tregun për t'i shitur.

116. Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se në vitin 2023, djali i tij, z. K. S., dhe bashkëshortja e tij kanë investuar vlerën prej rreth 14.900 eurosh për rikonstruksionin e shtëpisë së banimit në fshatin D., ku përfshihen dyert, dritaret, instalimet elektrike, vendosja e çatisë së re etj⁴⁶.
117. Në DIPP-në e vitit 2023⁴⁷, djali i subjektit ka deklaruar shpenzime të kryera, në total përgjatë vitit 2023, në shumën 14.936 euro, për rikonstruksionin e banesës në fshatin D. Referuar akteve të dosjes, këto pagesa janë kryer në favor të subjekteve tregtare që kanë kryer punime dhe ofruar shërbime nëpërmjet sistemit bankar, e konkretisht nëpërmjet UniCredit Bank Itali, të urdhëruara nga djali i subjektit.
118. Lidhur me të ardhurat e djalit, të cilat kishin shërbyer si burimin për riparimin e çatisë, subjekti ka parashtruar në ankim se nga data 15.03.2021, djali i tij K. S. është punësuar me kohë të plotë te ndërmarrja "(***)" SRL në Verona, dhe se për vitet 2021 – 2023, ka përfituar në total të ardhura në shumën 38.496 euro. Gjithashtu, edhe për bashkëshorten e djalit, znj. F. M., referon se ka punuar në të njëjtën ndërmarrje/shoqëri në shtetin italian dhe se për vitet 2021 – 2022, ka përfituar në total të ardhura në shumën 22.895 euro.
119. Në lidhje me investimet e kryera në pasuritë në analizë, Komisioni ka krijuar bindjen se djali i subjektit, z. K. S., dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht investimin e kryer mbi këtë pasuri në vitin 2023.
120. Ndërsa, sa u përket dyshimeve të ngritura për ndërtimin e katit shtesë dhe të një godine të re ngjitur me godinën ekzistuese, trupi gjyqësor arrin në të njëjtin përfundim me Komisionin se, nga aktet, nuk u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm, domosdoshmëria e pajisjes me leje ndërtimi për punimet e kryera e, në këtë kontekst, kjo rrethanë nuk mund të vlerësohet për efekt të këtij procesi.
121. Lidhur me pasurinë e llojit automjet i markës "Reno Modus", në vlerën 441.600 lekë⁴⁸, Komisioni ka arritur në përfundimin se: Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi dhe pagesën e detyrimeve doganore në lidhje me të, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

⁴⁶ Në mbështetje të deklarimeve të tij, ndër të tjera, subjekti ka depozituar: (i) kërkesën e bashkëshortes, datë 7.6.2023, për riparimin e çatisë, pa ndryshuar formën dhe karakteristikat kryesore ekzistuese të shtëpisë në fshatin D., së bashku me foto të objektit; (ii) vërtetimin e datës 7.6.2023, lëshuar nga Njësia Administrative Shkrelë; (iii) shkresën kthim përgjigjeje të Bashkisë Malësi e Madhe (sektori i urbanistikës), datë 7.6.2023, drejtuar shtetasit L. S., në të cilën listohen punimet të cilat nuk kërkojnë pajtuesjen me leje ndërtimi; (iv) faturën tatimore dhe mandatpagesat bankare që lidhen me punimet dhe instalimet e kryera në këtë objekt.

⁴⁷ Deklaratë e përcjellë me shkresën me nr. (**) prot., datë 12.06.2024, të ILDKPKI-së.

⁴⁸ DPShIRi, me shkresën nr. (**) prot., datë 03.02.2021 (protokolhuar në Komision me nr. (**) prot., datë 04.02.2021), ka bërë me dije për Komisionin se bashkëshortja e subjektit znj. L. S., ka pasur në pronësi automjetin me targë (**), blerë në datën 11.07.2012⁴⁹ nga shoqëria "(*)" ShPK, në çmimin prej 441.600 lekësh.



122. Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare, duhet të ishin konsideruar të ardhurat e mbartura nga vitet paraardhëse sipas aktit të ekspertimit financiar të depozituar prej tij (i referohet viteve në të cilat rezultoi me balancë pozitive), të ardhurat e realizuara nga shitja e bimës së shterbelës, si dhe ka kundërshtuar përfundimin e arritur nga Komisioni lidhur me shpenzimet e fëmijëve gjatë shkollimit në Itali.
123. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Autoveturë e markës "Reno Modus", e përdorur, prodhim i vitit 2005, me numër shasie {***}, blerë në Shqipëri më datë 11.07.2012, aktualisht e treguar me targë {***}. (Faturë tatimore shitjeje, me numër serie {***}, datë 11.07.2012, lëshuar "{***}" ShPK). Paraqes fotokopjen e njësuar. Është paraqitur pranë fush dhe më datë 20.03.2013. Blerë me kursimet nga puna si gjyqtar. Vlera e deklaruar është 441.600 lekë, me pjesë takuese 50% secili prej bashkëshortëve. Të njëjtin deklaram ka bërë dhe në DIPP-2012, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë.*
124. Trupi gjykues vëren se, referuar shkresës së DPSHTRr-së⁴⁹, evidentohet se automjeti i markës "Reno Modus", me targë {***}, është i regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit dhe është blerë përmes faturës tatimore⁵⁰ të lëshuar nga "{***}" ShPK më datë 11.07.2012, për çmimin prej 441.600 lekësh.
125. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen e kursimeve të viteve pararendëse, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë automjet "Reno Modus", trupi gjykues vëren se, përpos faktit që subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në asnjë nga deklaratat periodike për periudhën 2003-2016, nga analiza e kryer nga Komisioni, subjekti ka rezultuar me balancë pozitive vetëm për vitet 2005 dhe 2006, përkatësisht në vlerat 38.017 lekë dhe 44.850 lekë, ndërsa për të gjitha vitet e tjera ka rezultuar me balanca negative, çka e përjashton mundësinë e krijimit të kursimeve të mbartura⁵¹. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se, në mungesë të deklaratimeve të bëra mbi shtesa/gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratat e interesave private periodikë/vjetorë para vitit 2012, balancat pozitive të rezultuara nuk mund të prezumohen si kursime të subjektit të rivlerësimit.
126. Lidhur me pretendimin e subjektit për konsiderimin e të ardhurave nga shitja e shterbelës, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë automjet tip "Reno Modus", trupi gjykues vëren se ky pretendim është paraqitur për herë të parë nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit standard.
127. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë automjet "Reno Modus" vetëm kursimet nga paga si gjyqtar. Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2012, vit në të cilin është blerë kjo pasuri, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të saj. Po ashtu, në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën "Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private", subjekti ka deklaruar: *Të ardhura në vlerën 815.960 lekë, nga shitja e 4.742*

⁴⁹ Shkresa e DPSHTRr-së me nr. {***} prot., datë 03.02.2021.

⁵⁰ Faturë tatimore nr. {***}, datë 11.07.2012.

⁵¹ Në analizën financiare të kryer për periudhën 01.01.2012 - 11.07.2012 (data e blerjes dhe e zhdoganimit të automjetit) nuk janë përfshirë as të ardhurat e pretenduara nga shitja e shterbelës në shumën 350.000 lekë, për të cilat është bërë vlerësimi në sipër. Në analizë janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat nga paga e subjektit, që i përkasin periudhës objekti vlerësimi.

kg sherbelë e prodhuar në tokën time, në fshatin D., Njësia Administrative Shkrellë, Malësi e Madhe në vitet 2012, 2013, 2014, 2015. Ndërsa, në deklaratat periodike, rezulton se subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e sherbelës, konkretisht: (i) në vitin 2012 në shumën 350.000 lekë, për të cilat, si dokument justifikues është deklaruar fletëhyrja nr. {***}, datë 02.03.2013, lëshuar nga "{***}" ShPK, Rajzë; (ii) në vitin 2013 në shumën 220.000 lekë, për të cilat, si dokument justifikues është deklaruar fletëhyrja nr. {***}, datë 10.02.2014, lëshuar nga "{***}" ShPK, B.; si dhe (iii) në vitin 2015 në shumën 245.960 lekë, për të cilën nuk është deklaruar faturë përkatëse.

128. Trupi gjykues, në analizë të akteve të paraqitura, konstaton se subjekti ka depozituar dokumentacion nga i cili krijohen indicie se toka në pronësi apo përdorim të familjes së tij është kultivuar me sherbelë dhe se mund të jetë zhvilluar një aktivitet ekonomik i lidhur me grumbullimin dhe shitjen e këtij produkti bujqësor. Megjithatë, ekzistenca e një aktiviteti të tillë nuk mjafton, në vetvete, për të provuar realizimin e të ardhurave në vlerat e pretenduara nga subjekti. Dokumentet e paraqitura prej subjektit, të tilla si: fletëhyrje dhe fletëdalje të produktit, përbëjnë dokumentacion shoqërues të qarkullimit të mallit, por nuk kanë natyrën e dokumentacionit fiskal apo kontabël që provon realizimin e të ardhurave dhe përfitimin faktik të shumave monetare nga shitja e produktit dhe as nuk identifikojnë shoqërinë që ka pranuar/grumbulluar bimët medicinale. Këto dokumente nuk përmbajnë elementet e nevojshme për të vërtetuar çmimin e shitjes, vlerën e transaksioneve, mënyrën e pagesës apo arkëtimin efektiv të shumave të pretenduara. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka paraqitur fatura tatimore, dokumente financiare, ekstrakte bankare, mandatpagesa apo prova të tjera objektive që të mundësojnë verifikimin e sasisë së produktit të shitur, vlerës së përfituar dhe përfitimit real të të ardhurave. Në këtë drejtim, trupi gjykues mban në konsideratë se legjislacioni tatimor dhe ai kontabël kërkojnë që transaksionet ekonomike të dokumentohen me dokumente justifikuese që provojnë kryerjen e tyre dhe vlerën përkatëse financiare. Referuar ligjit nr. 9920/2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", në fuqi gjatë periudhave përkatëse, si dhe legjislacionit për dokumentimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, të ardhurat nga aktivitetet ekonomike duhet të mbështeten në dokumentacion fiskal dhe financiar që mundëson identifikimin e palëve, objektit të transaksionit, vlerës së tij dhe mënyrës së pagesës. Për rrjedhojë, fletëhyrjet dhe fletëdaljet e paraqitura nga subjekti, nuk përmbushin standardin ligjor të dokumentimit të të ardhurave dhe nuk mund të shërbejnë si provë e mjaftueshme për ekzistencën dhe masën e tyre.

129. Në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, është theksuar se barra e provës për ligjshmërinë dhe ekzistencën e burimeve financiare bie mbi subjektin e rivlerësimit, i cili duhet të provojë jo vetëm ekzistencën e aktivitetit ekonomik, por edhe realizimin konkret të të ardhurave dhe disponueshmërinë e tyre. Në mungesë të dokumentacionit financiar dhe fiskal që provon në mënyrë të besueshme këto elemente, të ardhurat e pretenduara nuk mund të konsiderohen të provuara.

130. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, nuk arrin nivelin e provueshmërisë së kërkuar për të vërtetuar realizimin e të ardhurave nga shitja e sherbelës. Për rrjedhojë, ashtu sikurse ka vlerësuar edhe Komisioni, këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk konsiderohen si

të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Mungesa e dokumentacionit ligjor justifikues dhe mosdeklarimi i plotë i tyre në deklarimet periodike, përbëjnë elemente që çojnë në konkluzionin se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.

131. *Në lidhje me shpenzimet e jetesës së fëmijëve të subjektit në Itali, përkundër nga sa ka pretenduar subjekti, trupi gjyqës, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁵², e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit që, në një qasje garantiste, fëmijëve të subjektit të rivlerësimi t'u llogaritet si shpenzim ditor vetëm vlera prej 5 eurosh në ditë për person, për sa kohë provohet rezidenca e palës pritëse dhe pranohet prej tyre mbulimi i shpenzimeve.*
132. Për sa është analizuar më sipër, ashtu sikurse ka konkluduar Komisioni, për pasurinë e llojit automjet i markës "Renault Modus", me targë {***}, subjekti i rivlerësimi rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të përballuar pagesën e çmimit të automjetit dhe shpenzimet e zhdoganimit në datën 11.07.2012, në vlerën prej (-) 723.717 lekësh, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.
133. *Lidhur me analizën financiare për periudhën 1993-2003 dhe 2004-2016, Komisioni ka konkluduar se: [...] referuar kësaj analize, rezultoi një balancë negative fondesh, në total në vlerën prej rreth 14,5 milionë lekësh, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimi dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1993 – 31.12.2003, si dhe vitet 2004, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.*
134. Subjekti, në ankim, lidhur me analizën financiare të Komisionit për periudhën 1993 – 2003 dhe 2004 - 2016, përsëriti të njëjtat pretendime të analizuar më sipër lidhur me konsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga puna para emërimit të tij si gjyqtar, të ardhurave nga shitja e bimëve medicinale, huave dhe dhurimeve të përfituara pas djegies së shtëpisë, pretendime të cilat i ka parashtruar edhe përpara Komisionit, pas njohimit të rezultateve të hetimit administrativ. Po ashtu, subjekti ka kundërshtuar mënyrën e përlogaritjes së shpenzimeve për jetesën e dy fëmijëve në Itali. Sipas subjektit, balancat negative të konstatuara nga Komisioni, janë të pabazuara dhe nuk pasqyrojnë gjendjen reale financiare e, për rrjedhojë, analiza financiare duhet të kryhet bazuar në përlogaritjet sipas aktekspertimit financiar të paraqitur prej tij.
135. Nga shqyrtimi i aktit të ekspertimit, trupi gjyqës konstaton se përlogaritjet e kryera nga eksperti, nuk janë mbështetur në dokumentacion ligjor. Analiza është bërë në mënyrë kumulative, ku balancat pozitive të viteve paraardhëse, janë konsideruar si të ardhura për vitin pasardhës, edhe pse subjekti nuk kishte deklaruar kursime *cash* për periudhën 2003-2016. Gjithashtu, janë përfshirë të ardhurat nga shitja e bimëve medicinale dhe huatë, ndërsa shpenzimet për fëmijët me qëndrim në Itali, nuk janë konsideruar në këtë analizë.

⁵² Shih vendimin e Kolegjit të Pasqurimit të Apelit nr. 11/2019 (JR).

136. Si rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se raporti i vlerësimit nuk provon të ardhurat e ligjshme ndër vite, pasi është hartuar mbi baza hipotetike, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit dhe mbi orientimin e tij dhe, si i tillë, nuk ka vlerë provuese për sasinë e të ardhurave në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
137. Lidhur me analizën financiare për periudhën 1993 – 31.12.2003, për të cilën Komisioni ka konstatuar një balancë negative në vlerën (-) 5.864.049 lekë, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, arriti në përfundimin se balanca negative për këtë periudhë, rezulton në vlerën (-) 5.388.961 lekë. Kjo diferencë është rezultat i reduktimit të shpenzimeve të jetesës për periudhën 1993 – 1999, nga 3.014.375 lekë në 2.539.287 lekë. Ky ndryshim afekton edhe balancën totale negative për të gjithë periudhën e analizuar, duke e reduktuar vlerën e konstatuar nga Komisioni prej rreth 14,5 milionë lekësh, në vlerën rreth 14 milionë lekë. Për vitet 2004, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, trupi gjykues vlerëson se konfirmohen balancat negative të konstatuara nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultuan me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.
138. Deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, lidhur me huatë e marra në vitin 2009, nuk u vlerësuan se cenonin figurën e gjyqtarit e, për rrjedhojë, as besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues në kuadër të vlerësimit mbi besueshmërinë e tij në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
139. Gjithashtu, mënyra e përfitimit nga subjekti i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme të llojit "tokë bujqësore" me sipërfaqe 6.300 m², trull me sipërfaqe 300 m² dhe shtëpi banimi njëkatëshe me sipërfaqe 90 m², të ndodhura në fshatin D., Njësia Administrative Shkrelë, Bashkia Malësi e Madhe, u vlerësua se nuk cenon figurën e gjyqtarit e, për rrjedhojë, as besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por u mbajt gjithashtu në konsideratë në kuadër të vlerësimit mbi arritjen e nivelit të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
140. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

141. Trupi gjykues vëren se, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se gjetjet e konstatuara nga rivlerësimi i këtij kriteri, pavarësisht se nuk janë çmuar të mjaftueshme për të arritur në një konkluzion sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të vlerësuara në tërësi me gjetjet nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, janë çmuar se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
142. Në lidhje me konstatimin për tejkalimin e afatit standard të gjykimit në disa dosje, subjekti ka parashtruar se afatet e gjykimit nuk janë prekluzive, por orientuese për gjykatën e, për

rrjedhojë, vonesat duhen vlerësuar në varësi të natyrës së çështjes. Po ashtu, subjekti ka referuar si argument lidhur me vonesat, numrin e lartë të gjykrimeve që i janë caktuar për gjykim, si dhe faktin se ka qenë i komanduar në gjykata në rreth të ndryshme, ndërkohë që ishte i emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

143. Në lidhje me mosdokumentimin me regjistrim audio të seancave (nga 25 seanca vetëm 1 është regjistruar), subjekti ka shpjeguar se ka qenë në pamundësi absolute dhe i kushtëzuar nga mungesa e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi vetëm dy salla mundësonin regjistrim audio. Ndërsa, lidhur me fillimin me vonesë të 3 prej 25 seancave gjyqësore të vëzhguara, subjekti ka parashtruar se shkak ka qenë vonesa e prokurorit, avokatit dhe e të pandehurit, dhe se në çdo rast iu është bërë me dije palëve, pavarësisht se nuk është pasqyruar në procesverbal nga sekretarja gjyqësore.
144. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, trupi gjykues, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenet 72 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për secilin rast të gjykuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme me bazën ligjore përkatëse, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrektësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin me efektivitet të procesit gjyqësor.
145. Sa u takon pretendimeve në lidhje me regjistrimin me sistemin "audio" të seancave gjyqësore, trupi gjykues çmon se kjo problematikë lidhet me infrastrukturën e gjykatave të rrethëve, të cilat përgjithësisht hasin vështirësi për shkak të mungesës së pajisjeve. Megjithatë, edhe pse seancat duhet të dokumentohen me regjistrim audio, në funksion të transparencës, për sa kohë nuk ka pasur ankesa, denoncime apo pretendime të palëve ndërgjyqëse, lidhur me këtë problematikë, trupi gjykues vlerëson se kjo mangësi nuk mund të ngrihet në atë nivel penalizues për subjektin e rivlerësimit.
146. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar 12 denoncime të depozituara nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime në lidhje me pesë denoncime, konkretisht për: (i) vonesa në arsyetimin e vendimeve përtej afatit ligjor; (ii) zvarritje të procesit gjyqësor përtej afateve standarde të kohëzgjatjes së gjykrimeve; (iii) shtyrje të seancave gjyqësore pa dokumentacion provues mbi shkaqet e shtyrjeve; (iv) vendimmarrje përtej tagrave ligjorë; (v) konstatime në lidhje me cenimin e cilësisë së vendimeve, sikurse pasqyrohen në mënyrë të detajuar në vijim.
147. Lidhur me denoncimin e shtetasës A. A., e cila ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka tejkaluar afatin e arsyetimit të vendimit, subjekti ka prapësuar se në kohën kur ka gjykuar çështjen objekt denoncimi, të finalizuar prej tij me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2022, ka qenë i komanduar si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, ndërkohë që ishte i emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Për rrjedhojë, vonesat në zhvillimin e seancave gjyqësore dhe zbardhjen e vendimeve kanë qenë pasojë e ngarkesës në punë dhe jo si rezultat i paaftësisë apo mungesës së impenjimit të tij. Po ashtu, subjekti ka referuar nenin

41 të ligjit nr. 84/2016, me pretendimin se shtrirja e kontrollit të vlerësimit profesional në vitin 2021, është tej afatit të periudhës së rivlerësimit profesional.

148. Trupi gjykues vëren se, bazuar në nenin 382/2 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: *Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.* Ndërsa në pikën 4 të këtij neni, parashikohet shtyrja e afatit, si vijon: *Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast, njoftohet kryetari i gjykatës.* Në kushtet kur në periudhën kur është gjykuar kjo çështje, subjekti ka qenë i komanduar në Gjykatën e Apelit, si dhe në konsideratë të dinamikës dhe ngarkesës së punës në gjykatat e apelit, trupi gjykues vlerëson se vonesa për arsyetimin e vendimit në këtë rast, nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.
149. Lidhur me denoncimin e shtetasve M. dhe S. B., të cilët kanë pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur gjykimin e çështjes penale, me objekt "Kërkesë për gjykimin e procedimit penal me nr. {***}/2018 të Prokurorisë së Rrethit Shkodër", subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se çështja në fjalë ka qenë komplekse për nga numri i të pandehurve, karakteri i pretendimeve të paraqitura, për faktin se janë ndërruar 3 prokurorë, si dhe për ndarjen e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Y. R., për shkak se ishte larguar jashtë shtetit. Në total, sipas pretendimeve të subjektit, janë zhvilluar 31 seanca gjyqësore, 11 prej të cilave nuk janë zhvilluar për shkak se nuk është paraqitur prokurori, ndërsa 12 seanca të tjera janë shtyrë për mosparaqitje të të pandehurve në gjykim, për të cilët është vendosur shoqërimi i detyrueshëm. Subjekti ka pretenduar se afatet e gjykimit nuk janë prekluzive (pasi po të ishin të tilla, akuza do të hinte me tejkalimin e tyre), por orientuese për gjykatën për të vlerësuar në mënyrë të arsyeshme kohëzgjatjen e një procesi mesatar penal, si dhe ka potencuar se edhe në lidhje me këtë çështje, shtrirja e kontrollit të vlerësimit profesional nga Komisioni, është bërë tej afatit të periudhës së rivlerësimit profesional.
150. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, vëren se⁵³ procedimi penal me nr. {***}/2017, në ngarkim të 5 të pandehurve, të afërm me njëri tjetrin (Y. R., H. R. etj.), i gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, është finalizuar me vendimin e tij me nr. {***} ({***}), datë 23.12.2019, nëpërmjet të cilit është vendosur: *Deklarimi fajtor i të pandehurve H. R., A. R., B. R. dhe A. R., për kryerjen e veprës penale "Plagosje e lehtë me dashje", e kryer në bashkëpunim, veprë kjo e parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 3 muaj burgim [-].* Referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, vërehet se janë shtyrë 16 seanca gjyqësore (7 muaj), kryesisht për mungesë të të pandehurve.
151. Referuar pikës 5, shkronja "a" e Aneksit 1 të "Sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve"⁵⁴, gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë nuk duhet të zgjasin më tepër se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale. Në rastin konkret, kjo çështje është regjistruar më datë 18.01.2019 dhe ka përfunduar në datën 23.12.2019. Pra, edhe në konsideratë të dinamikës dhe ngarkesës së punës në gjykatat e shkallës së parë, tejkalimi i afatit të përcaktuar për përfundimin e gjykimit,

⁵³ Shkresa me nr. {***} prot., datë 24.3.2024 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 27.5.2024.

⁵⁴ Miratuar me vendimin e KLD-së me nr. {***}, datë 14.4.2010.



vlerësohet si një mangësi në drejtim të aftësive organizative të subjektit, por nuk rezultoi me peshë përcaktuese në kuadër të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

152. *Lidhur me denoncimin e shtetases E. S., e cila ka pretenduar se subjekti është i korruptuar, pasi në gjykimin e procedimit penal të regjistruar me nr. {***}/2017, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i K. Penal, ai ka paragjykuar çështjen, ka shkelur etikën profesionale, nuk ka arsyetuar vendimin, pasi nuk u është përgjigjur kërkesave të ngritura në proces, por ka vendosur sipas kërkesës së prokurorit. Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti në këtë çështje nuk ka shfaqur cilësi të mjaftueshme në drejtim të aftësive për të interpretuar ligjin, për të arsyetuar vendimin, mangësi këto të cilat do të vlerësohen bashkë me gjetjet e tjera të evidentuara në këtë vendim.*
153. Subjekti, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm, ka pretenduar se Komisioni, në vlerësimin e kësaj çështjeje, ka dalë jashtë funksionit të tij, duke marrë rolin e Gjykatës së Lartë, duke mos mbajtur në konsideratë se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Sipas subjektit, nëse në 20% apo 30% të vendimeve të tij do të ndeshej një praktikë e tillë e plotësimit të vendimeve nëpërmjet vendimmarrjes së gjykatave më të larta, atëherë me të drejtë do të krijohej hapësirë për të vlerësuar aftësitë e tij vendimmarrëse, por në rastin konkret, nuk është mbajtur në konsideratë se nga kjo vendimmarrje, nuk ka asnjë pasojë të dëmshme për asnjë nga palët.
154. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, konstatoi se çështja penale është regjistruar në datën 25.02.2019, mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Shkodër, *Për pushimin e hetimeve të procedimit penal me nr. {***} datë 4.10.2017, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, me vendimin me nr. {***} ({***}), datë 8.5.2019⁵⁵, subjekti ka vendosur: 1. Pranimin e kërkesës së Prokurorit. 2. Pushimin e procedimit penal me nr. {***}/2018, regjistruar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi fakti për të cilin është regjistruar ky procedim nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se të kallëzuarit nuk kanë kryer veprën penale për të cilën janë dyshuar [...] etj.*
155. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 22.07.2019, ka vendosur: *Lënen në fuqi të vendimit nr. {***} ({***}), datë 08.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak se denoncuesja nuk legjitimohet të paraqesë ankën ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}/2017.*
156. Në vijim, denoncuesja i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke kërkuar: *(1) Ndreqjen dhe plotësimin e vendimit penal nr. {***} ({***}), datë 08.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në lidhje me provat materiale të sekuestruara gjatë hetimit për llogari të procedimit penal. (2) Deklarimin e falsitetit të dokumentit deklarativ të datës 26 tetor 1988, "Për heqjen dorë nga pasuria shtëpi banimi", dhe asgjësimin për shkak të falsifikimit të përmbajtjes dhe nënshkrimeve në këtë akt.*

⁵⁵ Denoncuesja ka kallëzuar veprime të paligjshme nga disa nëpunës të shtetit gjatë procesit të lëshimit të lejes së ndërtimit për pronën e saj. Prokurori i çështjes ka kërkuar pushimin e hetimeve, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

157. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 27.7.2020, ka vendosur: 1. Pranimin e kërkesës së paragjitur. 2. Ndreqjen e disa gabimeve materiale të konstatuara në vendim. 3. Provat materiale të sekuestruara për llogari të procedimit penal, mbajtja e të cilave ndalohet me ligj, të konfiskohen, të kalojnë në favor të shtetit, ndërsa sendet e tjera t'u kthehen personave që u takojnë. 4. Bazuar në nenin 391 të K.Pr.Penale, deklarimin e falsitetit vetëm për sa u përket nënshkrimeve të dokumentit "Deklaratë e datës 26 tetor 1988, "Për heqjen dorë nga pasuria shtëpi banimi". Asgjësimin e këtij dokumenti, por duke vënë më parë në dijeni personin që e ka paraqitur këtë dokument. 5. Pjesët e tjera të këtij vendimi mbeten siç janë. 6. Ky vendim t'i bashkëngjitet vendimit të korigjuar e të plotësuar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
158. Nga analizimi i dy vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, por edhe sipas pretendimeve të këtij të fundit në ankim, vërehet se ai ka pranuar se në vendim, nuk ishte shprehur në lidhje me kërkesën për kthimin e akteve që kanë shërbyer për kryerjen e aktekspertizave, dhe as në lidhje me deklarimin e falsitetit të aktit "Deklaratë e datës 26 tetor 1988", nëse e vlerësonte si të tillë. Pretendimi i subjektit se nuk mund të dispononte në vendim për aktet e sekuestruara nga Prokuroria, deri kur vendimi të merrte formë të prerë në apel, u gjet i pabazuar nga trupi gjyqësor.
159. Për sa më sipër, trupi gjyqësor vlerëson se, ndonëse subjekti në këtë çështje ka shfaqur mangësi në aftësinë për të interpretuar ligjin e për të arsyetuar vendimin, ajo nuk mund të ngrihet në nivel të tillë për të justifikuar një konkluzion në kuadër të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
160. Lidhur me denoncimin e shtetasit P. G.⁵⁶, i cili ka ngritur pretendime për tejzgjatje të shqyrtimit të procedimit penal nr. {***}/2015, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", çështje e cila është finalizuar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. {***} ({***}, datë 06.04.2018⁵⁷, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me shpalljen e vendimit, duke i shtyrë seancat pa shkaqe të arsyeshme dhe se, nga mosshpallja e vendimit për një afat relativisht të gjatë, subjekti i rivlerësimit ka cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt ligjor, duke vështirësuar realizimin e të drejtave të tyre brenda afateve ligjore, çka çmohet se përbën shkak për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
161. Subjekti ka pretenduar se shtyrja e shpalljes së vendimit ka ndodhur për shkak të kompleksitetit të çështjes, të ngarkesës në punë, e komandimeve për gjykime në gjykata të tjera (për periudhën kohore 19.02.2018 – 06.04.2018), lejes për arsye familjare e shëndetësore, për shkak të festave

⁵⁶ Denoncuesi ka kallëzuar disa punonjës shtetërorë për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", me pretendimin se i kishin shembur në mënyrë të padrejtë ndërtesën, vështje e cila është pushuar me vendim të prokurorit të datës 07.07.2015, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Vendimi i pushimit është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe është vendosur detyrimi i prokurorisë për vazhdimin e hetimeve, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Organi i prokurorisë ka vijuar hetimet dhe, në përfundim, ka disponuar sërish me vendim për pushim të hetimeve të procedimit penal me nr. {***}/2015, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës".

⁵⁷ Administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.5.2024.

zyrtare etj. Sipas subjektit, fakti që ky vendim është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta⁵⁸, si dhe duke qenë se denoncuesi e ka ushtruar të drejtën e tij për t'u ankuar, nuk ka vend që të pretendohet për cenim të të drejtave për një proces të rregullt ligjor.

162. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore të përcjellë pranë Komisionit nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër⁵⁹, vërehet sa vijon.

- Me vendimin e datës 27.07.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, datë 20.03.2015, për veprën penale "Shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i K.Penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

- Mbi bazën e ankimit të paraqitur nga denoncuesi, datë 29.07.2017, është investuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku çështja është regjistruar në datën 30.09.2017. Subjekti i rivlerësimit ka caktuar seancën gjyqësore në datën 17.10.2017. Vërehet se, për gjykimin e kësaj çështjeje, janë zhvilluar 17 seanca, nga të cilat 12 gjyqësore dhe 5 seanca për shpallje vendimi. Nga këto seanca, vërehet se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë për mungesë të palëve/prokurorit të çështjes. Në seancën e datës 19.02.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes duke u tërhequr për vendim.

- Për marrjen e vendimit ka zhvilluar 5 seanca, nga data 28.02.2018 deri në datën 06.04.2018, datë në të cilën ka shpallur vendimin. Referuar procesverbaleve gjyqësore, vërehet se si shkaqe për shtyrjen e seancave për vendimmarrjen, janë referuar kryesisht arsye shëndetësore, angazhime në trajnime/seminare, shkaqe këto të përsëritura disa herë nga subjekti.

163. Në nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale, me titull "Menjëhershëmëria e marrjes së vendimit", përcaktohet se: *(1) Vendimi merret menjëherë pas diskutimeve përfundimtare të palëve. (2) Marrja e vendimit nuk mund të shtyhet, përveçse në rast pamundësie absolute. Shtyrja vendoset nga kryetari me urdhër të motivuar.* Referuar kësaj dispozite, normohet rëndësia e fuzës së shpalljes së vendimit, duke e lidhur me detyrimin për ta shpallur menjëherë pas diskutimeve përfundimtare. Nga ana tjetër, për shkaqe të pamundësisë absolute, parashikohet shtyrja e seancës kundrejt një procedure, e cila detyrimisht kërkohet të miratohet nga kryetari. Trupi gjykues vëren se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor pretendimet e tij se ka pasur shkaqe të arsyeshme për shtyrje dhe se, nga data 19.02.2018 deri më datë 06.04.2018, nuk është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkaqe të arsyeshme e të ligjshme⁶⁰. Në vendimin e datës 07.03.2018, të kryetarit të gjykatës, për

⁵⁸ Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 28.06.2018, ka vendosur: "Lënia në fuqi të vendimit nr. {***} ({***}), datë 06.04.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë nga shtetasi P. G., Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 06.07.2023, ku vendosur: "Mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankuesi P. G. kundër vendimit numër {***}, datë 28.06.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër".

⁵⁹ Shkresa me nr. {***} prot., datë 16.5.2024.

⁶⁰ Në ankim, subjekti parashtroi se: "Në periudhën kohore 19.02.2018 - 06.04.2018, kam pasur ngarkesë të madhe pune, kam gjykuar çështje në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Kurbín, kam marrë pjesë në seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, kam qenë me leje për arsye familjare e shëndetësore, tre nga ditët efektive të punës kanë qenë pushim për shkak të festave zyrtare [...]". Subjekti ka dhënë detyrë për secilën datë dhe festat përkatëse zyrtare.

miratimin e lejes për tri ditë (në datat 9, 12 e 13 mars të vitit 2018, referohet se, në këto data, subjekti nuk ka planifikuar gjykime dhe, për pasojë, nuk bëhet pengesë për mbarrëvajtjen e proceseve.

164. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shtyrja e seancave pa shkaqe të arsyeshme nga subjekti i rivlerësimit, tregon qasje të pakujdesshme të tij në kuadër të respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, veprimet e subjektit në këtë rast, nuk konsiderohen të një rëndësie të tillë për t'u bërë shkak për penalizimin e tij në kuadër të vlerësimit mbi cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
165. Lidhur me disa çështje të tjera të evidentuara gjatë hetimit administrativ, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga institucionet e verifikimit, trupi gjykues konstaton se, në lidhje me çështjen me të pandehur shtetasit E. T. dhe A. N., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimmarrja për llojin, masën e dënimit dhe mënyrën e ekzekutimit të tij, ka qenë e bazuar në ligj dhe në prova, si dhe bazuar në bindjen e tij të brendshme dhe vetëm një gjykatë më e lartë ka të drejtë që ta rivlerësojë dhe ta ndryshojë. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për dy të pandehurit, sipas nenit 59 të Kodit Penal, është bërë në vlerësim të rrethanave lehtësuese – ku krahas evidentimit të rrethanave familjare, ka parashtruar edhe se të pandehurit kanë pranuar fajësinë, kanë shfaqur penesë dhe kanë rregulluar marrëdhëniet ndërmjet tyre.
166. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve, konstatoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dërguar për gjykim çështjen në ngarkim të shtetasve A. N. dhe E. T., duke kërkuar: (1) Deklarimin fajtor të të pandehurit E. T., për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" që parashikohet nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të pandehurit E. T., për kryerjen e veprës penale "Kanosja", që parashikohet nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri E. T. të dënohet përfundimisht me 4 vjet burgim. Aplikimin e uljes së dënimit në masën 1/3, në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e dënuar të pandehurin E. T. përfundimisht me 2 vjet e 8 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur dhe të vihet në shërbim prove i pandehuri E. T. (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit A. N., për kryerjen e veprës penale "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", që parashikohet nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A. N., për kryerjen e veprës penale të "Plagosjes së rëndë me dashje", që parashikohet nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri A. N. të dënohet përfundimisht me 6 vjet burgim. Aplikimin e uljes së dënimit në masën 1/3, në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e dënuar të pandehurin A. N. përfundimisht me 4 vjet burgim.
167. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. (***) ((***)), datë 20.02.2018, për të pandehurit E. T. dhe A. N., ka vendosur të njëjtën masë dënimi me atë që ka kërkuar prokurori, me ndryshimin se për të pandehurin A. N., në aplikim të nenit 59 të K. Penal, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për pjesën e pavuajtur, duke e vënë të pandehurin A. N. në provë, me kusht që gjatë kohës së provës, të mos kryejë veprë tjetër penale. Vendimmarrja e subjektit sa i takon pezullimit të ekzekutimit të dënimit të dhënë ndaj të

pandehurit A. N., është ankimuar nga prokurori dhe, në vijim, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga prokurori i çështjes.

168. Nga aktet, rezultoi gjithashtu se ngjarja ka ndodhur në datën 19.05.2017 dhe ekzekutimi i masës së sigurimit personal "Arrest me burg", sipas vendimit të datës 09.06.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të pandehurin E. T., është bërë pas vetëdorëzimit të tij (pasi ishte arratisur) në polici në datën 08.01.2018. Ndërsa, ekzekutimi i masës së sigurimit personal "Arrest me burg" ndaj të pandehurit A. N. është bërë pas vetëdorëzimit të tij në polici në datën 29.01.2018. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka zhvilluar 4 seanca gjyqësore⁶¹ dhe e ka shpallur vendimin në datën 20.02.2018. Në momentin e shpalljes së vendimit, i pandehuri E. T. kishte qëndruar rreth 1 muaj e 12 ditë në paraburgim x 1,5 ditë sipas nenit 57 të K. Penal = 63 apo 64 ditë, pra rreth 2 muaj burgim (i konvertuar), ndërsa i pandehuri A. N., kishte qëndruar rreth 22 ditë në paraburgim x 1,5 ditë sipas nenit 57 të Kodit Penal = 33 ditë, pra rreth 1 muaj burgim (i konvertuar)⁶².
169. Në analizën e kësaj çështjeje, trupi gjyqësor vëren se subjekti i rivlerësimit, në ushtrimin e diskrecionit gjyqësor për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duket se nuk ka kryer një vlerësim të plotë të të gjitha rrethanave faktike të rastit konkret. Nga shqyrtimi i vendimit, rezulton se nuk janë marrë në konsideratë në mënyrën e duhur elemente me rëndësi për individualizimin e përgjegjësisë penale dhe vlerësimin e rrezikshmërisë së të pandehurit, si: natyra dhe rrezikshmëria e veprave penale të kryera, pasojat potenciale që mund të vinin prej tyre, si dhe rrethanat konkrete të realizimit të veprës. Po ashtu, konstatohet se i pandehuri kishte mbajtur dhe përdorur armë zjarri në ambiente publike, sjellje e cila paraqet një shkallë të konsiderueshme rrezikshmërie shoqërore dhe që është kryer me dashje të drejtpërdrejtë. Nga të dhënat e administruara, rezulton se i pandehuri e ka parashikuar karakterin e kundërligjshëm të veprimeve të tij dhe, megjithatë, me vullnet të lirë ka vijuar realizimin e tyre, duke konsumuar dy vepra penale.
170. Gjithashtu, trupi gjyqësor evidenton se në këtë vendimarrje, nuk është vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme fakti që i pandehuri u është shmangur organeve të drejtësisë për një periudhë rreth gjashtëmuajore, rrethanë e cila, në vetvete, përbën tregues të qëndrimit të tij ndaj ligjit dhe procesit penal. Gjithashtu, si element në favor të aplikimit të alternativës së dënimit, është konsideruar normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet familjeve, ndërkohë që, nga aktet, rezulton se nismat për pajtimin dhe rivendosjen e raporteve janë ndërmarrë nga familjarët e të

⁶¹ Dy seanca janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokuroris dhe mbrojtësit të një prej të pandehurve, një seancë për shkak të kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe një seancë për përgatitjen e konkluzioneve.

⁶² Shtetasi A. N. i dënua për veprën penale "Plagosja e rëndë me dashje", parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, i cili përcakton masë dënimi nga 5 deri në 10 vjet burgim, si dhe për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, i cili përcakton masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim, përfundimisht ka qëndruar vetëm 22 ditë në paraburgim. Ndërsa, E. T. i dënua për kryerjen e veprës penale "Kanosja", parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, e cila përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 1 vit burgim, si dhe për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, i cili përcakton masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim, përfundimisht ka qëndruar vetëm 1 muaj e 12 ditë në paraburgim.

pandehurve përmes një deklarate noteriale dhe jo nga vetë i pandehuri, çka kufizon peshën që kjo rrethanë mund të ketë në vlerësimin e pendesës apo rehabilitimit të tij.

171. Megjithatë, pavarësisht mangësive të konstatuara në arsyetimin dhe vlerësimin e këtyre rrethanave, trupi gjykues çmon se ato nuk arrijnë nivelin e shkeljeve të tilla që të cenojnë në mënyrë thelbësore funksionin gjyqësor apo të provojnë një mungesë të theksuar profesionalizmi. Vlerësimi i rrethanave për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, përbën pjesë të diskrecionit gjyqësor dhe, ndonëse në rastin konkret ky diskrecion nuk rezulton të jetë ushtruar në mënyrë bindëse, problematikat e evidentuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka kryer veprime ose mosveprime që cenojnë besimin e publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
172. Për sa më sipër, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues arriti në konkluzionin se mangësitë e konstatuara nga Komisioni në gjykimin e çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, nuk u konsideruan se janë të tilla që të cenojnë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
173. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit, bazuar në konkluzionet e arsyetuara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, vendimi i Komisionit nr. 795, datë 04.09.2024, është i mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 795, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tonin Sterkaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 13.01.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

